



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.03.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 14:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte të EWMI.

6. Arben Lila, eksperti projektit EU4Justice (prezent vetëm në pikën e parë në sallë.)

7. {...}, Inspektore jomagjistrate pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

8. {...}, Inspektor magistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

9. {...}, Këshilltare për komunikimin dhe median në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

10. {...}, gjyqtar.

11. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

12. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Ilir Rusi: Përhëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme datë 19.03.2024.

Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor është në një angazhim institucional jashtë kufijve të Shqipërisë. Për këtë arsye mbledhja do të drejtohet nga ana ime, Ilir Rusi Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas rendit të ditës, pika e parë e saj është zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Ftoj administratën për të verifikuar prezencën e përfaqësuesit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të subjektit magjistratit z. {...}.

(Futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së, znj. {...} dhe z. {...}, si dhe magjistrati {...}.)

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj seance dëgjimore dhe pas njoftimit të bërë nga administrata e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), prezent në këtë seancë dëgjimore është {...} {...} dhe zoti {...}, me detyrë inspektorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) që të përfaqësojnë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. {...} me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, autorizim i cili mban numrin 644/3, datë 19.03.2024. Gjithashtu është prezent edhe magjistrati z. {...}.

Sipas përcaktimeve ligjore, ftoj përfaqësuesit e ILD-së për të parashtruar argumentet e tyre në lidhje me këtë procedim disiplinor, duke theksuar faktin që të mos kaloni në përsëritje në raport me atë çfarë është paraqitur deri më tani.

{...} {...}, fjala për ju!

{...}: Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. {...} prot, datë 16.05.2023, ka vendosur: “Fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit”, ndaj magjistratit {...}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit, të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “dh”, dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në analizë të identifikimit të elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë, ekzistencën e shkeljes disiplinore, si dhe nuk diktojnë mbylljen e hetimit disiplinor, nga

provat e administruara në kuadër të këtij procesi hetimor, rezulton se në rastin konkret për sa i përket shkeljeve disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “dh”, dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, nuk ekziston asnjë rrethanë faktike apo element juridik që dikton mbylljen e hetimit disiplinor nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mbështetje të parashikimeve të nenit 117, nenit 120, pika 1, shkronja “b”, “ç”, “d” “dh”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, i ndryshuar.

Në analizë të kriterit “lloji dhe rrethanat e shkeljes” në raport me faktet e provuara gjatë hetimit disiplinor, rezulton se nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor {...} janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat kanë sjellë përfitim të padrejtë për palët në një proces gjyqësor në kundërshtim me ligjin, si pasojë edhe e zbatimit të gabuar të ligjit material dhe procedural, të konkretizuara këto gjatë dhënies së vendimit nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, për “lirim para kohe me kusht” të kërkuarit {...}, vendimit nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021 për “lirim me kusht” të kërkuarit {...}, vendimit nr. 21/124, datë 23.09.2021 për “ulje dënimi” për kërkuarin {...}, vendimit nr. 22/21-2200, datë 22.11.2019 për “lirim me kusht” të kërkuarit {...}, vendimit nr. 06, datë 27.03.2018 për “lirim me kusht” të kërkuarit {...}. Këto veprime/mosveprime parashikohen si shkelje disiplinore nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 102 pika 2 shkronjat “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”.

Në analizë të kriterit “shkalla e fajësisë dhe motivi”, në raport me faktet e provuara në kuadër të kësaj procedure hetimore krahas provave të cilat pasqyrojnë fakte apo rrethana mbi kryerjen e shkeljeve disiplinore të analizuara më lart dhe në raportin e ILD-së, janë administruar edhe prova të cilat pasqyrojnë fakte apo rrethana mbi të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore apo kriminale të magjistratit. Gjithashtu, në analizë të vendimeve të tjera të magjistratit ku janë zbatuar kushtet kumulative të nenit 64 të kodit penal, çojnë në përfundimin se shkelja disiplinore e parashikuar nga neni 102, pika 1, germa “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” e konsumuar prej tij në vendimarrjet e analizuara në raport, është kryer me dashje, me qëllimin përfitimin e padrejtë të “lirimit me kusht” dhe “uljes së dënimit”.

Ndërsa në analizë të kriterit “pasojë e shkeljes” rezulton se nga veprimet e magjistratit subjekt hetimi disiplinor, në rastin e shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit

{...}; {...}; {...}, ka ardhur si pasojë lirimi me kusht dhe ulja e padrejtë e dënimit, në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural, duke i sjellë përfitime të padrejta të dënuarve, e cila është dhe pasoja e drejtpërdrejtë e shkeljes disiplinore. Kryerja e veprimeve/mosveprimeve të para si një sjellje në tërësinë e vet nga ana e magjistratit {...} ka cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë qëllimin e institutit të lirimimit me kusht të parashikuar nga norma ligjore. Në të njëjtën kohë, ushtrimi i parregullt i detyrës nga ana e magjistratit ka sjellë si pasojë për dhënien e drejtësisë, cenimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij, si dhe ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

Në këto kushte, duke iu referuar nenit 3, pika 5, të ligjit nr. 96/2016 është parashikuar se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes dhe forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien e sigurimit të drejtësisë, besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë një garanci e demokracisë dhe stabilitetit të shoqërisë demokratike. Në këto kushte, arrihet në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e magjistratit {...} kanë cenuar vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet t'i përcjellë publikut në përmbushjen e misionit dhe rolit të tij në dhënien e drejtësisë.

Në analizë të çështjes mbi llojin dhe masën disiplinore, vlerësohet se sipas parashikimeve të nenit 105 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, konstatohet se kjo dispozitë në përputhje me parimin e ligjshmërisë, i cili kërkon që masa disiplinore të përcaktohet nga ligji, parashikon detyrimin për përzgjedhjen e masave disiplinore të parashikuara nga kjo dispozitë. Në të njëjtën kohë, për të mundësuar zbatimin e parimit të drejtësisë, objektivitetit, individualizmit dhe proporcionalitetit, parashikon një listë prej 6 masash disiplinore (nga më e lehta tek më e rënda), me qëllim që ndaj magjistratit të jepet ajo masë e cila është e domosdoshme dhe e dobishme për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij dhe në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer. Në të njëjtën kohë masa disiplinore që caktohet ndaj magjistratit përmbush edhe dy qëllime parandaluese: (i) parandalimin e posaçëm, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe (ii) parandalimin e përgjithshëm, në kuptimin që magjistratët e tjerë të kuptojnë që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

Ndërkohë, në rastin kur shkelja disiplinore është aq e rëndë sa që e bën magjistratin të papërshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar funksionin e tij, atëherë masa disiplinore nuk mund të luajë më rol edukues. Kjo masë disiplinore përcaktohet pikësisht në nenin 140, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit gjyqtari shkarkohet nga detyra kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; dhe kur gjyqtari b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Në të njëjtën kohë kjo masë parashikohet edhe në nenin 111 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, ku parashikohet përgjegjësia disiplinore e magjistratit për një shkelje shumë të rëndë, që e bën atë të papërshtatshëm ose të padenjë për të vazhduar ushtrimin e funksionit.

Në këto raste, Kushtetuta ka parashikuar në disa norma detyrimin e gjyqtarëve për të respektuar me përpikëri Kushtetutën, ligjet dhe për të ruajtur paanësinë e figurën e pastër në funksionin e dhënies së një drejtësie. Nëse konstatohen akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e gjyqtarit ose pamjaftueshmëri profesionale, organet përgjegjëse duhet të mbajnë qëndrimin e duhura deri në shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Për sa më sipër, nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara, duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore; (ii) rrethanat e shkeljes së kryer, të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të përsëritur të legjislacionit material dhe procedural; (iii) kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit me dashje direkte; (iv) përvojën e konsiderueshme të magjistratit në sistemin gjyqësor dhe mospasjen e vlerësimeve profesionale; (v) pasojat e shkeljes disiplinore lidhur me përfitimin e padrejtë të lirimit me kusht të dënuarit, të cilët përbëjnë rrezik për shoqërinë në kundërshtim me parimet e legjislacionit material dhe procedural; (vi) cenimin e imazhit të sistemit gjyqësor dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë; (vii) ekzistencën e rrezikut të shkaktuar nga shkelja disiplinore pasi sjellja e papërshtatshme nuk shtrihet vetëm tek magjistrati subjekt i hetimit disiplinor, por rrezikon të ndiqet edhe nga magjistratë të tjerë si dhe krijon terren për sjellje të papërshtatshme; (viii), mungesën e ndonjë arsye specifike që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor, faktin që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën “shkelje shumë të rëndë

disiplinore”, arrihet në konkluzionin se magjistrati {...} në vendimmarrjet e tij ka kryer shkelje të rëndë profesionale, duke diskredituar rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

Duke mbajtur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore të magjistratit, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duke u siguruar që masa e dhënë e parashikuar nga ligji dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit; duke u bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore; individualizimit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë e cila është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, vlerësohet për shkeljen disiplinore të kryer nga magjistrati {...}, të jepet masa disiplinore “Shkarkim nga detyra”, parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 1, shkronja, “dh” dhe pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”.

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Lartë Gjyqësor të administrojë provat e paraqitura nga Inspektori i Lartë në këtë procedim disiplinor dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “dh”, nenit 111, pika 1, shkronja “a”, dhe nenit 146, shkronja “b” të ligjit nr. 96/ 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të vendosë:

“Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...} me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër”, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” dhe pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe “Caktimin ndaj magjistratit {...} të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj subjektin magjistratin {...} për të parashtruar argumentet e veta.

{...}: Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ).

Të nderuar përfaqësues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD).

Unë kam paraqitur një material dhe disa prova mbështetëse të pretendimeve dhe kundërshtimeve që kam në lidhje me raportin e paraqitur për caktimin e masës disiplinore në ngarkimin tim.

Nëse më lejoni t'i përmbledh në mënyrë të shkurtuar pa qenë e nevojshme për ta lexuar të gjithën.

Provat janë paraqitur sipas kërkesës së bërë nga drejtuesi i seancës, në afatin e kërkuar në lidhje me këtë procedim.

Pikë së pari unë do të jap disa konsiderata të përgjithshme në lidhje me këtë procedim disiplinor dhe më pas pastaj në mënyrë të përmbledhur do fokusohem tek çështjet konkrete. Në radhë të parë, përveç një çështjeje, të gjitha çështjet që ka referuar Inspektori janë çështje të cilat përfshihet afati i parashkrimit të ndjekjes të hetimit disiplinor.

Çështja konkrete sa i përket “lirimit me kusht” të {...}t është tej afatit 5-vjeçar. Inspektori është përpjekur të argumentojë se kemi të bëjmë me raste të ngjashme, por në fakt të gjitha ato çfarë ka konstatuar sipas tij në raportin disiplinor, asnjëra nuk është e ngjashme. Pra në të gjitha vendimet ka konstatuar që janë problematika të ndryshme; nuk ka asnjë problematikë të ngjashme.

Në rastin e {...}t ka konstatuar që gjykata ka vlerësuar gabim provat në arsyetimin e shkaqeve subjektive që janë arsyet e veçanta për të cilat ka vendosur “lirimin me kusht”.

Kjo çështje është tej afatit 5-vjeçar, nga momenti i paraqitjes së kërkesës për procedim kanë kaluar 5 vjet e 6 muaj dhe për këtë çështje unë kërkoj së pari nga KLGJ-ja që ta konstatojë të parashkruar.

Për këtë çështje ka bërë ankesë {...}.

Çështja e dytë është çështja e uljes së dënimit dhe lirim me kusht për të dënuarin {...}. Inspektori, siç u shpreh edhe inspektorja sot, relatton që këto janë bërë me nismë të ankuesit. Në fakt shkresa kundër meje në lidhje me “lirimin me kusht” të {...} është një shkresë fyese, denigruese që, që në pamje të parë, po ta lexosh, duket që s'është një ankesë e një pale të interesuar apo që ka ardhur në dijeni të një fakti të paligjshëm sepse

aty përmendet veprimtaria si gjyqtar, veprimtaria si drejtues i gjykatës, veprimtaria si njeri para se unë të bëhesha gjyqtar. Dërguar në emër të një personi i cili ka konfirmuar nëpërmjet një deklarate noteriale pranë ILD-së që nuk është ai personi që e ka kryer këtë ankim. Kjo deklaratë i ka vajtur... kjo është deklarata e fundit dhe shkresa e fundit që kam dërguar pranë Inspektorit në lidhje me faktin që ky është një ankim i rremë, është një ankim an anim, pasi më parë, të njëjtën shkresë, të njëjtën ankesë, një gjyqtare e shkarkuar e Gjykatës Gjirokastër e kishte bërë me emër të një avokati të njohur, por edhe në moshë, që punon pranë Gjykatës Gjirokastër, e cila falë kallëzimit të avokatit edhe me insistimin e prokurorisë, u zbulua që këtë shkresë e kishte iniciuar dhe dërguar një gjyqtare e shkarkuar e Gjykatës (e shkarkuar nga shkalla e parë e vetting-ut) Gjirokastër. Të gjitha këto fakte unë ia kam parashtruar Inspektorit, i kam çuar edhe një raport për procedimin disiplinor në datën 8 korrik 2022, për këtë, për procedimin disiplinor të kësaj gjyqtareje, bashkëngjitur edhe provat procedurale penale. Nuk është kthyer asnjë përgjigje, pavarësisht kërkesave të mia të njëpasnjëshme për të marrë dhe patur një informacion.

Pra ajo që pretendohet që ka nisur me nismë të ankuesit, në rastin e {...}. Ankimi është anonim. Inspektori e ka të ndaluar të marri në shqyrtim ankimet anonime. Unë në raport kam paraqitur edhe dispozitat përkatëse. Përfundimisht i merr kur kanë të bëjnë me sjellje të gjyqtarit, jo me vendimmarrje të tillë, pra me sjelljen, me etikën e gjyqtarit, por nuk jemi në rastin konkret. Dhe ajo që evidentohet është që për çudi, të gjitha vendimmarrjet në vijim dhe deri tek raporti i fundit disiplinor apo raporti i paraqitur, pavarësisht se pretendohet se ka dy ankesa, i janë çuar vetëm zonjës {...} dhe nuk i është njoftuar asnjë z. {...}. Dhe po të shihet në raportin që ju është dërguar juve, në fund fare thuhet që njoftohet vetëm {...}. Po zoti {...} pse nuk njoftohet? Pra është arritur bindja edhe nga Inspektori që kemi të bëjmë me... ajo shkresë një herë që në pamje të parë duket që nuk është një shkresë ankimore. Unë e kam kërkuar për të ma paraqitur, për të ma vënë në dispozicion Inspektori edhe në kuadër të këtij procedimi, për ta pasur ditën e sotme. Për dijëni shkresën dhe kërkesën drejtuar Inspektorit ia kam dërguar edhe KLGJ-së sepse isha i sigurt që nuk do ma sillnin përsëri, pas dhjetëra e dhjetëra shkresa e kërkesa, njoftime që kam kërkuar tek Inspektori, domethënë një mosfunksionalitet absolut në raport me të drejtën për informim të subjekteve të këtij institucioni. Nuk e

kam; nuk e dua sepse e di përmbajtjen sepse është “copy-paste” e shkresave të përsëritura të cilat vazhdimisht kanë rënë në dorën time dhe që unë kam vërtetuar që niseshin nga i njëjti person.

Edhe në lidhje me {...}n, pra lirimi me kusht i {...}s është tej afatit 5-vjeçar. Jo! Në mos gaboj. Një sekondë të lutem.

{...} (gjyqtari i referohet ndoshta z. {...} dhe z. {...}) është tej afatit 5-vjeçar. {...} është brenda afatit.

Pra, unë mendoj që kjo çështja për {...} ka qenë si pikë lidhëse e të gjitha këtyre çështjeve të tjera për t’u patur në qendër dhe pastaj është komplementuar me çështjet e tjera për t’u bërë sa më e besueshme kjo kërkesë për procedim disiplinor.

Unë normalisht do paraqes edhe raportin tim, por ajo që ma ka lehtësuar punën ka qenë edhe një raport që ditët e fundit na u vendos në dispozicion si Këshillit të Lartë Gjyqësor ashtu edhe gjykatave, në lidhje me inspektimit tematik të lirimeve me kusht të kryera nëpër gjykata, ku pjesë përbërëse e inspektorëve janë dhe dy inspektorët të cilët kanë hetuar dhe kanë dalë në këtë konkluzion në lidhje me personin tim, pra qenien ajo jo gjyqtar në vijim dhe që ndodhen edhe sot prezent. Dhe çfarë konstatoj? Unë konstatoj që ka vlerësime të ndryshme sa i përket raportit tematik në lidhje me vlerësimet që janë kryer në rastin tim. Konkretisht në raportin tematik është evidentuar nga inspektorët që kemi të bëjmë me 2 praktika të gjykatave në të gjithë Shqipërinë. Ky është një raport shumë i detajuar, evidentohen çështje konkrete e gjyqtarë konkretë, vendimmarrje të ndryshme të gjyqtarëve të veçantë; dhe aty evidentohet që ka një grup gjyqtarësh të cilët në lidhje me 2/3 ose 3/4 e dënimit, një grup gjyqtarësh e aplikojnë mbi masën e dënimit të dhënë nga gjykata dhe një grup gjyqtarësh e aplikojnë mbi masën e dënimit që ka parashikuar dispozita penale që është dënuar personi. Ekziston edhe një vendim i Gjykatës së Lartë. Ky vendim i Gjykatës së Lartë është pro faktit që 2/3 ose 3/4 e dënimit do të aplikohen mbi masën e dënimit që ka dhënë gjykata (është vendim i Gjykatës së Lartë, është përmendur edhe në raportin e inspektorëve, atë tematikun dhe tek kundërshtimet dhe parashtrimet e mia unë e kam përmendur). Gjithashtu, inspektorët vetë kanë evidentuar që një grup magistratësh në vitin 2010, 2020, falë punës së tyre kanë evidentuar faktin që në respektim të të gjithë të drejtave të të dënuarve dhe rehabilitimi, resocializimi i tyre, është e nevojshme që të aplikohet 2/3 ose 3/4 e dënimit mbi

dënimin e dhënë nga gjykata. Dhe inspektorët referojnë që Gjykata e Lartë është mirë që në këto raste të ndërhyjë me vendim unifikues për të unifikuar dhe për të pasur një qëndrim. Ndërsa, në lidhje me raportin tim, konstatohet shkelje shumë e rëndë, që unë paskam aplikuar koeficientin e vuajtjes së dënimit 2/3, 3/4 në lidhje me dënimin e dhënë nga gjykata.

Tani, unë dua të sqaroj këtu, që në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që përfshin dhe IEVP Tepelenë, IEVP Tepelenë ka qenë burg shumë i vogël. Aktualisht që prej vitit 2021, në mos gaboj, funksionon vetëm si paraburgim dhe ka qenë një numër shumë i vogël të dënuarish, me dënime shumë të ulëta. Kështu që të gjithë të dënuarit, në momentin që janë shpallur, gjykata jo 2/3 por 3/4 dënimit, jo dënimin të dhënë por edhe të dënimit që parashikonte dispozita penale, kanë qenë të gjitha të plotësuara.

Diçka tjetër që bie ndesh me gjetjet është edhe momenti i paraqitjes së kërkesës për “lirim me kusht”, nëse në këtë moment i dënuari duhet të plotësonte 2/3 ose 3/4 e dënimit apo kjo masë dënimi duhet të plotësohej në momentin e shpalljes së dënimit. Është konstatuar që pothuajse të gjitha gjykatat (besoj me ndonjë përjashtim shumë të vogël), të gjithë gjyqtarët aplikojnë llogaritjen e dënimit në momentin e shpalljes së dënimit. Ky ishte dhe qëndrimi që ka pasur grupi i magjistratëve që kishin studiuar ose kishin bërë një punim në lidhje me këtë pjesë, që çuditërisht tek mua quhet shkelje dhe fillojnë edhe pastaj sjellin edhe insinuata të tilla sikur unë paskam kryer një veprimtari të kundërligjshme për të plotësuar i dënuari në momentin e paraqitjes së kërkesës dënimin e parashikuar në ligj.

Unë kam aplikuar, domethënë i qëndroj mendimit që 2/3 ose 3/4 e dënimit duhet të aplikohen mbi masën e dënimit që ka dhënë gjykata, pavarësisht se po të shikosh të gjitha vendimet, për shkak të masës së vogël të dënimit që ka pasur personi, të gjithë personat në momentin e liruar kishin plotësuar jo më 2/3 por edhe 3/4 e dënimit.

Ka një problematikë në lidhje me llogaritjen e kohës së punës, që inspektorët kanë bërë një përlllogaritje dhe i kanë hequr një personi rreth një muaj e ca, por që kjo nuk është evidentuar në vendim. Edhe tek inspektimi tematik ka qëndrime të ndryshme. Ne nuk kemi pasur. Domethënë koha e punës tek ne ka qenë përlllogaritur 1, 2 ose 5 ditë. Pra nuk kemi pasur një problematikë të tillë.

Duke u fokusuar tek çështjet konkrete, në lidhje me të dënuarin {...}, është evidentuar gjatë gjykimit që certifikata e gjendjes gjyqësore e paraqitur në gjykim ka pasur shënimin “i padënuar”. Raporti i IEVP-së ka qenë raport pozitiv pro kërkesës “për pranim”. Raporti i Shërbimit të Provës ka qenë pro kërkesës “për pranim”. Qëndrimi i prokurorit në seancë ka qenë pro kërkesës “për pranim”. Gjykata ka vendosur, pra unë kam vendosur në cilësinë e trupit gjykues “pranimin e kërkesës” dhe nuk ka pasur ankim.

Çfarë është evidentuar këtu? Këtu Inspektori ka kërkuar, ka marrë informacion nga Prokuroria Sarandë dhe ka evidentuar që ky person ka qenë i dënuar për një kundërvajtje penale, pavarësisht se vetë e evidenton që për kundërvajtjen penale në rastin konkret personi nuk quhet përsëritës. Pra kundërvajtja penale nuk është një shkak negativ që nuk lejon personin të përfitojë nga e drejta për “lirimin me kusht”. Ka arsyetuar më mbrapa dhe thotë që dënimi i personit në lidhje me këtë kundërvajtje penale duhet të ishte marrë në shqyrtim nga gjykata në vlerësimin e provave, pra në realizimin dhe në vlerësimin e ekzistencës së kushteve të veçanta, pra arsyeve të veçanta pse duhet të pranohet kërkesa.

Po t’i referoheni të gjithë inspektimit tematik, pra raporti i inspektimit tematik që ka nëpër gjykata, e vetmja gjë që nuk kanë hyrë inspektorët, është vetëm vlerësimi subjektiv. Unë e kam shkruar në raport. Domethënë në të gjitha gjykatat shkruajnë jo më shumë se një paragrafë e gjysmë dhe ky paragrafi ka apo s’ka dy apo tre fjali. Sepse e kanë evidentuar edhe aty, e kanë bërë mirë punën e tyre sepse normalist kjo punë do të lexohej nga të gjithë, që vlerësimi i provave të gjykatës dhe vendimmarrja e gjykatës nuk mund të jetë objekt kontrolli nga Inspektori, vlerësimi i provave dhe vendimmarrja e gjykatës është objekt kontrolli vetëm nga Gjykata e Lartë (nga një gjykatë më e lartë), siç nuk rezulton në rastin konkret. Nëse inspektorët do t’i hyjnë kriterit subjektiv dhe pastaj do vlerësojnë provat tona, atëherë ne nuk do bëjmë më vendime që mund të kontrollohen nga gjykatat më të larta, por do bëjmë tema diplome, me mendimin që do t’i kontrollojë Inspektori dhe si të ketë (më fal për shprehjen) oreksin Inspektori, një herë e pranon, një herë nuk e pranon. Vlerësimi i provave është atribut vetëm i gjykatës, nuk është atribut i Inspektorit.

Tani duke punuar materialin, ne kemi edhe ato vendimet e tjera, që Inspektori është shprehur për arshivimin dhe në një nga këto, në disa që unë kisha, ka përdorur

shprehimisht këtë shprehje (është vendimi 119/1 prot, datë 17.07.2023 në lidhje me një arkivim të një ankese të kryer në një çështje që unë kam gjykuar) dhe shprehet: *Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe i provave gjatë një procesi gjyqësor është atribut vetëm i pushtetit gjyqësor. Vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe besueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë.*

Pra kjo qasje që ka në raport me respektimin e ligjit Inspektori, në shumicën e vendimmarrjeve të tij, në rastin konkret në raportin që ka paraqitur ndaj meje në hetimin disiplinor bërë ndaj meje, jo vetëm që nuk është mbajtur në konsideratë, por përkundrazi inspektorët kanë hyrë me detaje duke analizuar tej kompetencave të tyre, provat që ka marrë në shqyrtim gjykata. Më vjen keq ta them por në disa raste edhe duke i shtrembëruar ato. Pra ndryshe shprehet inspektori dhe ndryshe janë provat që janë paraqitur në raport.

Kështu që tek rasti i {...}t unë kam vlerësuar të gjitha provat dhe nuk kam gjetur asnjë shkak pse këtij personi të mos i njoh të drejtën që i njeh ligji për të përfutur (se nuk ia jap unë, ia jep ligji) lirim me kusht sepse përmbushte të gjitha kriteret, ato procedurale formale të nenit 477 të K.Pr.Penale dhe ato materiale të parashikuara në nenin 64 (në mos gaboj) të K.Penal.

Inspektori shprehet në lidhje me, në situatën aktuale ku ne kalojmë “përhapja e dhunës në familje”, gjykata duhet të marri.... Në fakt kjo është një situatë që politikën penale nuk e bën gjykata. Ky është qëndrimi im. Edhe në seminare unë jam i mendimit që gjykata nuk duhet të bëjë politikën penale. Politikën penale e bëjnë institucionet e tjera, e bën qeveria dhe aq më tepër legjislatori. Edhe në raportin tematik, në këtë pjesë, përsëri inspektorët janë shprehur që legjislatori bën politikën penale dhe nuk e bëjnë. Në rastin konkret duhet ta bëja unë. Dhe politikën penale unë duhet ta bëja ndaj një personi që kishte ushtruar dhunë ndaj vajzës së tij sepse e kishte larguar nga familja e re ku jetonte, ku vajzat e kishin mbajtur dhe i kërkonin llogari që pse ai nuk kujdesej edhe për to siç kujdesej për familjen tjetër. Ajo s’ ishte as ndonjë dhunë, se po qe për dhunë, unë kam dhënë edhe vendime të tjera që duhet të ishin objekt inspektimi por çuditërisht nuk janë vërejtur, por në rastin konkret aty edhe elementi i dhunës ka qenë shumë i lehtë. Ky ka

qenë një persona që ka pas përgjegjësi edhe ndaj fëmijëve të familjes që ishte ndarë me bashkëshorten (që e kishin kallëzuar) por edhe me familjen e re, fëmijëve që kishte. Tani, nëse do zbatohesh politika penale ndaj këtij personi, unë nuk e di, por unë nuk mendoj që ky ishte një person që duhej të rrinte edhe tre muaj në burg (sa janë nga gjykata), se pasi të mbaronte këto tre muaj ai do ishte rehabilituar më mirë apo do kishte një sjellje më të mirë, apo edhe shoqëria do ndihej më mirë sepse u realizua politika penale ndaj {...}. Por gjithsesi unë i mëshoj faktit që pjesa e kritereve të veçanta, parashikuar në ligj, është vlerësimi i provave që e bën gjykata. Pra nuk mund t'i hyjë dot Inspektori, siç nuk e ka bërë në gjithë raportin e inspektimit tematik që kanë bërë në gjykatat. Nuk ka asnjë faqe, që unë e kam sjellë “copy-paste” tek raporti kundërshtues, nuk ka asnjë material ku të hyjë dhe të analizojë mënyrën e vlerësimit të provave në gjykatë në lidhje me kriterin subjektiv, kështu e cilëson, kriterin subjektiv. Jep disa konsiderata të përgjithshme, jep faktin që magjistratët në të gjithë Republikën e Shqipërisë i referohen vendimit unifikues të vitit 2015 në lidhje me kriterin e “arsyeve të veçanta”, por nuk hyn se si gjykatat kanë vlerësuar provat. Pastaj kriteret formale i ka marrë në vijim në shqyrtim.

Kjo ka qenë vendimmarrja ime në lidhje me {...}. Unë vlerësoj që nuk ka asnjë gabim që të jetë evidentuar dhe {...} të ketë përfituar me pa të drejtë lirim me kusht.

Edhe Inspektori në raportin tematik edhe praktikat gjyqësore, gjykatat i referohen vetëm në lidhje me përcaktimin e faktit nëse është i dënuar ose jo, i referon certifikatës së gjendjes gjyqësore të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Unë nuk besoj se ndonjë gjyqtar ka detyrimin ligjor ose duhet ta shtrijë hetimin e tij pa u pretenduar nga palët që të hetojë vërtetësinë e dokumentit të sjellë nga institucioni shtetëror. Pra nëse Drejtoria e Burgjeve sjell “i padënuar”, unë jam i detyruar ta konsiderojë “i padënuar”. Vetëm në rast se nga palët do ngrëjë më pas pretendime dhe do të më thotë që unë kam një informacion të ndryshëm dhe ky informacion duhet të merret nga gjykata sepse unë jam në pamundësi për ta sjellë, atëherë po, unë mundem që të hetojë. Në rastin konkret nuk është ngritur asnjë pretendim. Edhe në vendimin e dënimit që ka dhënë gjykata e shkallës së parë unë kam lexuar rrethanat e faktit për të pasur një dinamikë se si ka ndodhur dhe nuk kam hyrë për të lexuar në thellësi arsyetimin sepse ishte dënuar personi. Se pse është dënuar personi, ai është dënuar dhe është një vlerësim i gjykatës. Unë s’jam një gjykatë më e lartë që ta vlerësoj e ka dënuar drejt/saktë, ka dhënë masën e dënimit

ose jo. Rrethanat e faktit deri diku mua më duhen për ta njohur çështjen për ta vlerësuar edhe personin në kompleksitet të rrethanave, të raportit të IEVP-së, por edhe faktit penal që ka ndodhur. Kështu që edhe në rast se do të ishte evidentuar në gjykim dhe do të ishte ngritur ky pretendim pra që personi ka qenë i dënuar më parë për një kundërvajtje penale, kjo kundërvajtje penale nuk përbënte shkak që ai të konsiderohej përsëritës dhe të mos përfitonte nga lirimi me kusht.

Në lidhje me çështjen për “lirimin me kusht” të {...}, në fillim, rreth muajit shkurt (se nuk i mbaj mend datat) është paraqitur kërkesë për “lirimin me kusht”. Në seancë gjyqësore, kërkuesi ka paraqitur kërkesën për tërheqje nga kërkesa, me pretendimin që do ta ngrejë në një moment të mëvonshëm. Unë kam vlerësuar dhe pa i hyrë shkaqeve dhe kam thënë që investimi i gjykatës është ekskluzivitet drejtpërdrejt i personit, - do, e vazhdon gjyqin, do, nuk e vazhdon; -do, vjen në gjykatë, do, nuk vjen në gjykatë. Asnjë nga palët ndërgjyqëse nuk ka kompetencë të vazhdojë gjykimi tej kërkesave të tij, pavarësisht shkaqeve pse ai tërhiqet. Ato shkaqe mua nuk më interesojnë. Aludohet që personi është tërhequr se nuk plotësonte kriterin e parashikuar në ligj. Po, edhe kjo mund të jetë. Ai ka menduar se mund të përfitonte nga 2/3 e dënimit, ndërkohë që duheshin 3/4, e ka vlerësuar të tillë dhe është tërhequr. Kam bërë një arsyetim të shkurtër, duke arsyetuar ekskluzivitetin e paraqitjes së kërkesës dhe vijueshmërinë e gjykimit dhe kam vendosur “pushimin e gjykimit” në lidhje me këtë pjesë.

Ka rezultuar që në muajin gusht dhe në muajin shtator janë paraqitur dy kërkesa të reja nga i njëjti person, një “lirim me kusht” dhe një kërkesë për “ulje dënimi”. Unë kam qenë drejtues i gjykatës atëherë dhe në muajin korrik ne kemi dalë me një urdhrin, edhe urdhrin e kam cituar me numër dhe me datë në parashtrime dhe kam thënë që për shkak të pushimeve vjetore të gjykatës në muajin gusht, të gjitha çështjet që do paraqiteshin në gjykatë, do shortoheshin me shortin e parë që ishte në datën 13, duke llogaritur gjithë këtë periudhën e pushimit. Në datën 13 janë shortuar të gjitha çështjet, midis të tjerave edhe kërkesa për “lirimin me kusht” dhe kërkesa për “ulje dënimi”. Të dyja çështjet me short më kanë rënë mua. Shorti është kontrolluar nga inspektorët.

Tani inspektorët në fakt e kanë evidentuar këtë punën e mirë që unë kam bërë, se mua më kanë kontrolluar të gjitha shortet që janë bërë. Nuk është gjetur asnjë lloj shkeljeje, se patjetër do ta kishin evidentuar. Mua më janë kontrolluar të gjitha masat e

sigurimit që kam dhënë kur kam qenë gjyqtar. Mua më kanë kontrolluar të gjitha sigurimet e padive. Nuk e di pse bëhet ky kontroll kaq shumë?! A thua që tërë problematika e Gjykatës Gjyrokastër paska qenë tek mua. Shyqyr tek të gjitha të tjerat nuk është gjetur gjë, s'ka pasur asnjë problem.

Fokusohemi tek problemi këtu. Me short të dyja çështjet me kanë rënë mua. Shorti ka qenë elektronik dhe është kontrolluar. Nuk ka asnjë lloj problemi me shortin. Kam kryer, për sa i përket uljes së dënimit, e kam kryer brenda afatit 10-ditor, duke u quajtur një manovër e imja që të përfitonte personi 90 ditë ulje dhe pastaj të plotësonte atë afatin që nuk e plotësonte në datën 13, ishte vetëm 8 ditë. Pra duhej ulur 90 ditë për të plotësuar 8 ditë në datën 13. Ndërkohë që thuhet që të gjitha gjykatat dhe gjyqtari konkret e llogarit në datën e dhënies së vendimit por në rastin konkret është aluduar sikur unë kam manipuluar pa fund aty që ky personi të plotësonte afatin. Tani unë e kam shqyrtuar brenda 10 ditëve. Unë kam sjellë, se shumë pak kemi pasur, rreth 20 “ulje dënimi”, dhe të gjitha uljet e dënimit që kam dhënë unë, të gjitha janë brenda afatit 1-mujor. Të gjitha ne i kemi bërë, ashtu e gjeta praktikën, ashtu e vazhdova dhe ashtu e kam lënë, i kemi bërë brenda afatit 1-mujor. Unë gjithmonë seancat e para i lija, mundohesha të gjeja këtë afatin 15-ditor që parashikon Kodi i Procedurës Penale, pavarësisht ngarkesës, të gjitha janë bërë me një seancë (duket aty). Nuk ka as edhe një rast që të ketë një seancë të dytë. Kështu ka ndodhur edhe në rastin konkret. Është kryer brenda muajit të gjitha gjykimet e tjera dhe unë të gjitha vendimet i kam dhënë 90 ditë ulje dënimi. Dhe ky rast nuk bën përjashtim. Ajo është vendimmarrja ime. Unë ashtu e kam vlerësuar dhe kam vlerësuar që personat e dënuar në rastet që kanë një sjellje pozitive gjatë vuajtjes së dënimit duhet të vlerësohen ligjërisht në vlerësimin tim me maksimumin që parashikon ligji për t'i stimuluar ata në vijimësi të sjelljes së tyre gjatë vuajtjes së dënimit, apo edhe duke ndikuar tek personat e tjerë. Të gjitha vendimet i kam me 90 ditë. Kështu është edhe ky vendim, është me 90 ditë ulje. Nuk kam gjetur ndonjëherë në gjykim ndonjë arsye që pse unë duhet të merrja rol aktiv (në vlerësimin tim, të padrejtë) dhe duhet pastaj të arsyetoja që pse mos të jepja 90 ditë por të jepja 70 ditë, 75. Se unë kam parë edhe 89 ditë. Nuk e di pse s'jepet 90 dhe jepet 89 ditë?! Ka kolegë që kanë dhënë edhe 89 ditë. Ajo një ditë çfarë pune ka prishur, unë nuk e di?! Nuk i kam hyrë kësaj pune. Nuk më është kërkuar asnjëherë dhe kam dhënë gjithmonë atë që parashikon. Nuk i kam dhënë asnjërit 91

ditë, pra t'i jap një ditë më tepër seç parashikon ligji. 90 ditë i kam dhënë, i kam dhënë edhe personit konkret.

Pretendohet nga Inspektori që unë e kam dhënë uljen e dënimit pa një raport specifik të IEVP-së Tepelenë. Në pamje të parë thashë mos kam gabuar dhe vajta hapa direkt dosjen dhe shoh që në provat e para ishte vlerësimi i IEVP Tepelenë në lidhje me kërkesën për “ulje dënimi”. Pra IEVP-ja Tepelenë e bën vetë punën e saj. Atje ka organ të specializuar. Ata e kishin sjellë dhe kishin bërë raportin e tyre ku në fund kërkonin “pranimin e plotë të kërkesës”. Tani pranimi i plotë i kërkesës ka qenë ashtu siç unë e pranova, 90 ditë. Nuk gjeta shkak pse. Tani unë kam bërë një gabim këtu. Unë 100%, se e thonë edhe inspektorët, por nuk u ka ardhur përshatë sepse u binte e gjithë kjo ngrehina. Unë këto 90 ditë që ia kam ulur këtij personit duhet t'ia kisha ulur tek lirimi me kusht. Unë nuk ia kam ulur. Pra në rast se unë paskam iniciuar gjithë këtë procedurë, t'ia bëja shpejt e shpejt, t'i ulja 90 ditë dhe jo 70 ditë, që ky të kapte këtë afatin që plotësonte ligji, po të kapte 2/3 apo 3/4 , pra të gjithë këtë, për çfarë do e bëja unë? – për t'ia ulur. Unë nuk ia kam ulur. E evidentojnë edhe inspektorët aty që nuk është ulur kjo. Kjo është shkelja. Unë duhet t'ia kisha ulur. Por këtë nuk e thonë. Nuk e ka ankimuar edhe personi sepse në përgjithësi ne vetë kemi qenë nëpër sallat e gjyqeve, edhe kur vijnë të shikojnë në dritë të syrit dhe thonë “po u lirova s’dua ta di; kam tre muaj apo kam katër muaj apo kam...”.

Jo, nuk ia kam përllogaritur.

E kam harruar. Nuk e kam përllogaritur. Ky është gabimi.

Këtë po e them unë. Ky nuk është në raport. Sepse në raport është ngritur i gjithë alibia sikur unë kam kryer gjithë këtë procedurën që ai të përfitonte që të kapte 8 ditë ulje dënimi dhe prapë personi ka qenë i dënuar me 5 vjet dhe sipas vendimit të Gjykatës së Lartë por edhe sipas praktikës që kanë shumica e gjykatave, deri në 5 vjet, duke përfshirë edhe 5 vjet, aplikohet 2/3 e dënimit të dhënë nga gjykata, jo 3/5 e dënimit. 3/5 aplikohet mbi 5 vjet. Në rastin konkret ky kishte bërë 4 muaj a 5 muaj më tepër. Kështu që kjo është historia në lidhje me këtë pjesën e uljes së dënimit.

Tek ulja e dënimit pretendohet që unë kam aplikuar ligjin gabim (unë e kam hedhur edhe tek raporti) sepse tek pjesa “për këto arsye, gjykata bazuar në nenin kaq, vendosi:...” unë kam lënë ligjin e vjetër, atë të 1998, më falni, nenin 63, vijon neni 75,

duke e konsideruar si zbatim i gabuar i të drejtës materiale. Po të shikosh në brendësi të vendimit, tek rubrika “ligji i zbatueshëm”, unë kam hedhur dhe kam thënë që është neni 75 i ligjit. Kam cituar edhe ligjin dhe pastaj kriteret i kam analizuar.

Tani gabimi material që është atje, të quhet “interpretim i gabuar i ligjit” nuk shkon. Tani unë vështirë se mund të gjej, se ne punojmë edhe me korrektor (këto që kanë Windows) vështirë se mund të gjej ndonjë vendim gjykate (edhe tek raporti që po lexoja tani, paska gabime materiale) që mos të ketë gabim. Tani, edhe tek raporti disiplinor ndaj meje që ka ardhur, nuk e di kush nga inspektorët e ka shkruar, përsëri edhe inspektori ka një gabim, se për {...} thotë IEVP Durrës, ndërkohë që ai ka qenë në Tepelenë. Se ç’punë ka pas {...} në Durrës?! Si duket edhe inspektorët, si puna jonë, për shkak të lodhjes ose ndonjëherë edhe për shkak të ngarkesës ne punojmë mbi vendime të tjera, mund të qëllojë që të ngelet ndonjë diçka por e rëndësishme është që ajo të mos jetë ndonjë gabim material që ndikon në thelb, në themelin e vendimit. Në rastin konkret ky është një gabim që asnjëherë gjykata nuk e ka korrigjuar kryesisht, asnjëherë palët s’e kanë kërkuar, por edhe sikur të mos ishte shkruar fare aty, s’ka rëndësi sepse në pjesën arsyetuese dispozita materiale është përmendur dhe është analizuar. Kështu që unë nuk e quaj zbatim të gabuar të ligjit, unë e quaj gabim material i njohur nga ligji dhe i parashikuar në dispozitë ligjore edhe mënyra se si mund të korrigjohet kur palët kanë interes. Kur palët s’kanë interes, ngelet diçka pa interes dhe aq më tepër ky është një vijimësi e dy ligjeve që shfuqizuan, pra ai i vitit 1998 (neni 63) dhe më pas doli viti 2020, që është neni 75 por që formalisht kanë të njëjtat kriteret. Nuk është se ndryshojnë kriteret e zbatimit.

Në lidhje me lirimin me kusht të {...}, pas shortimit unë kam caktuar seancën. Edhe tek ulja e dënimit prokurori ka qenë dakord dhe nuk është bërë ankim. Pra ky vendim ka marrë formë të prerë. Tek lirimi me kusht kam caktuar seancën. Në gjykim kanë ardhur dy... pra personi solli një dëshmi penaliteti ku thoshte “i padënuar”. IEVP-ja solli një dëshmi penaliteti që thoshte “i rehabilituar”. Unë kam vendimin dhe kam arsyetuar që rehabilitimi nuk është status por është proces. Personi është i dënuar o është i padënuar. I rehabilituar nuk duhet të jetë. Pra nuk duhet shënuar. Ky është një gabim që bën Drejtoria e Burgjeve. Sepse në mënyrë edhe indirekte ndikon tek personi ose tek subjekti që jep vlerësimin. Gjithsesi e kemi marrë në shqyrtim dhe kemi evidentuar që ky person (i dënuari, ishte diku tek 21-22 vjeç më duket, pra i ri në moshë), në kohën që

kishte qenë i mitur, kishte kryer një vjellje dhe ishte dënuar për të. Ishte rehabilituar. Unë kam shumë vendime dhe kjo ka qenë edhe një praktikë, një debat që ne kemi bërë dhe kemi ndryshuar edhe një praktikë të mëparshme të gjykatës Gjirokastër, që personat e rehabilituar, ne i quanim të padënuar. Dhe po t'i referohesh raportit të inspektimit tematik të kryer nëpër gjykata, pranohet si ide, edhe nga gjyqtarët që e aplikojnë, me përjashtime të vogla nëpër gjykata të ndryshme, por edhe nga grupi i magistratëve që kanë punuar në lidhje me këtë pjesë; edhe inspektorët tek raporti im disiplinor nuk është se kanë një qëndrim negativ, por thjesht e kanë lënë duke evidentuar faktin se ka qëndrime të ndryshme. Inspektorët thonë që raporti i IEVP-së ka qenë negativ. – Jo. Raporti i IEVP-së në lidhje me sjelljen e personit ka qenë pozitiv. Nëse duhet, unë e referoj por është pak i gjatë. Është i gjithi pozitiv por thonë “...ne jemi për rrëzimin e kërkesës sepse ka qenë përsëritës.”. Dhe për shkak të kësaj dualiteti që kam pasur edhe shërbimi i provës ka thënë që e lëmë në vlerësimin, pra ekziston mundësia, ndonëse e vështirë, për rehabilitim, ne e lëmë në çmim të gjykatës. Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të IEVP-së ka qenë personi që përfaqësonte IEVP-në në gjyq dhe unë e kam shtruar në diskutime dhe i kam thënë që ndajeni pjesën, ju e vlerësoni negativ sjelljen apo vetëm pjesën që ky person është përsëritës. Dhe ka thënë që ne vlerësimin në lidhje me sjelljen e kemi pozitive, por ne themi “rrëzimin e kërkesës për shkak se ky person është përsëritës”. Kanë marrë fjalën të gjitha palët dhe është evidentuar që... edhe prokurori fjalën e tij, -nëse duhet unë mund ta lexoj, se unë mendoj se ka rëndësi se këtu në fakt tek të gjitha gjykimet e mia ka qenë i njëjti prokuror. Prokurori i ekzekutimeve të Gjirokastrës ka qenë i njëjti. Koherent në të gjitha vendimet, edhe në ato që unë i kam sjellë, që i kam pasur rrëzime, është koherent, kemi pasur të njëjtin qëndrim. Jo se gjenim gjuhën paraprakisht, por proceduralisht ne e vlerësonim çështjen drejt dhe e gjykonim drejt. Tani, tek të gjitha kërkesat që unë kam pranuar, prokurori është shprehur “dakord me kërkesën” dhe nuk ka bërë ankim. Tani pse duhet të jem unë këtu dhe mos të jetë edhe prokurori këtu në krah meje? Se ky është një diskriminim tani që ndodh. Apo e kanë koleg? Se kështu i bie. Sepse unë duhet të kërkoja që të vinin gjyqtarë pastaj, mos të kërkoja që të vinin prokurorë. Edhe ai është zbatues i ligjit, edhe ai është subjekt i inspektimit. Ka një emër prokurori atje dhe prokurori ka shprehur të njëjtin vendim me mua. Megjithatë, po citoj vetëm pjesën e prokurorit (ndjesë se mbase po marrë shumë kohë). Prokurori thotë: Nuk ekzistojnë shkaqe negative

(flasim për {...}); nuk rezulton një periudhë sigurie e vendosur nga gjykata; nuk rezulton paraqitje e një kërkesë të rrëzuar brenda 6 muajve; plotësohet periudha e dënimit e kryer; Lidhur me rehabilitimin është fakt që është institut që e zhbën dënimin, në kuptimin që personi quhet i padënuar, nuk quhet përsëritës me dashje. Lidhur me mundësinë e integritit, të gjithë treguesit dhe sjellja e tij në IEVP si dhe treguesit e tjerë, predispozitat pozitive që ka pasur personi, do t'i shpalosi në botën e jashtme dhe me ndihmën e faktorëve të tjerë që personi të integrohet plotësisht. Në këto kushte shprehemi për pranimin e kërkesës “për lirimin me kusht”.

Shërbimi i provës, raportin pozitiv. IEVP-ja raportin pozitiv me pjesën “por”, që u diskutua dhe pastaj e vlerësonte gjykata nëse ky ishte përsëritës ose jo. Plotësonte kriterin jo vetëm 2/3 por edhe 3/4 e dënimit të dhënë edhe për dispozitën që ishte dënuar, pra e plotësonte të gjithë, e kanë evidentuar edhe inspektorët tek pjesa aty; dhe unë kam vendosur pranimin e kërkesës dhe kundër vendimit nuk është kryer ankim. I kam pezulluar masën e dënimit, pa aplikuar atë 90-ditëshin. Pra atë 90-ditëshin unë këtu e kam harruar dhe nuk e kam aplikuar.

Nuk është bërë ankim nga asnjë nga palët dhe vendimi është i ekzekutueshëm.

Inspektorët shprehen që dënimi i mëparshëm duhet të merrej përsëri tek arsyet e veçanta tek vlerësimi i provës, nëse ishte arritur ose nuk ishte arritur rehabilitimi i personit.

Pa rënë në përsëritje, ky është vlerësim i provave që kam bërë. Unë e kam vlerësuar të tillë. IEVP-ja ka qenë me vlerësim pozitiv. Ky ka pasur një moshë të re 21-22 vjeç. Ka sjellë edhe prova të tjera. Ka pasur një gjendje familjare, babai i kishte vdekur. Nëna ka sjellë prova që të trajtohej me kimioterapi, se e kishte me tumor. Një vëlla e kishte me një dorë, invalid të lindur. Pra i vetmi që punonte në familje ka qenë ky. Pavarësisht se për momentin kishte zgjedhur rrugën e keqe, por gjithmonë ligji është që prezumohet që personi për shkak të risocializimit të tij të marri rrugën e duhur; dhe shoqëria nëpërmjet gjykatës i jep edhe mundësinë që i fal disa muaj burg duke vendosur në provë me mendimin që këtij personi t'i bëhet edhe një çik shembull kjo pjesa që ne ta dhamë një herë dorën dhe ky është edhe roli human i të drejtës penale. Tani burg për të gjithë!

Është evidentuar dhe inspektorët kanë hyrë tek pjesa e sjelljes së personit brenda periudhës së vuajtjes së dënimit dhe kanë evidentuar që aty ka pasur një masë disiplinore disa vite më para. E para e punës, unë them që IEVP-të kudo që janë, kanë një komision të aftë profesionalisht dhe e njohin mirë ligjin. Por ajo që më bëri përshtypje është se tek raporti hetimor që është kryer ndaj meje, është një çështje “lirim me kusht” të {...}. Tek lirimi me kusht i {...} është ngritur pretendimi se ai ka pasur një masë disiplinore më para dhe unë e kam marrë në shqyrtim dhe kam analizuar të gjithë ligjin aty, sepse ligji thotë që me kalimin e 6 muajve dhe personi nuk kryen një kundërvajtje tjetër, kjo konsiderohet e pa dhënë. Pra kur kjo konsiderohet e pa dhënë, si do ta marrë në shqyrtim këtë? Dhe tek lirimi me kusht i {...} (e kam sjellë edhe si vendim, e kam bashkëngjitur materialeve që ju kam dërgua ju) e kam analizuar gjatë, dhe tek ky raporti e kam thënë, se pse personi (dhe raporti duhet marrë pozitiv), pavarësisht faktit se në një moment të caktuar mund të ketë pasur një masë disiplinore ndaj tij, të dhënë nga IEVP-ja ose drejtori i burgut, por që ligji e parashikon sitë tillë. Përtej kësaj, ky është një vlerësim që unë i kam bërë të gjitha provave. Kjo është fuqia që mua më jep ligji. Këtë fuqi mua ma kontrollon vetëm një gjykatë më e lartë. Inspektori nuk mund të hyjë dot këtu. Ka hyrë. Për mendimin tim ka bërë gabim që ka hyrë këtu; siç nuk ka hyrë në gjitha vlerësimet që ka bërë vendimeve në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë tek raporti i inspektimit tematik. Ky është vlerësimi që ne kemi bërë. Ky vendim ka ngelur në fuqi. Rrethanat kanë qenë të tilla. Unë kam dhënë vendim “për lirimin me kusht” të këtij personi. Kam vlerësuar dhe vlerësoj që të gjitha kushtet procedurale dhe ato materiale plotësoheshin në rastin konkret. Personi kishte të gjitha arsyet, qoftë për shkak të sjelljes së tij, qoftë për shkak edhe të kushteve familjare.

Kam lexuar në raport edhe këtë pjesën që personi nuk e pranon, nuk e ka pranuar. Në çdo 6 muaj, IEVP-ja kur bën raportin e vlerësimit si duket e pyet a e pranon ose jo. E para e punës, kjo nuk është e parashikuar asgjëkund që të jetë një shkak negativ në vlerësim. E dyta e punës, më fal po sa raste ka në botë që persona të dënuar padrejtësisht jo vetëm kanë kryer burgun por edhe janë dënuar me ekzekutim, pra me vdekje. Kush e heq të drejtën që ai të mendojë që ai është i pafajshëm. Pse duhet unë ta detyroj me kushtin që ti nuk përfiton dot lirimin me kusht, pa e parashikuar shprehimisht në ligj, që ti duhet të pranosh veprën. Nuk e pranon. Sepse ai ashtu e mendon dhe mund të jetë edhe i tillë, pavarësisht se prezumohet mbi bazën e vendimit të gjykatës se është i fajshëm.

Nesër pasnesër mund të dalin rrethana të reja, mund të rishikohet vendimi dhe ai të dalë i pafajshëm. Atëherë si do themi ne që e detyruam atë për të përfituar një të drejtë ligjore që duhet ta pranosh patjetër këtë që ti e ke kryer? Në qoftes ai e vlerëson që nuk e ka kryer, është vlerësimi i tij dhe ligji nuk e parashikon këtë. Kështu që të shtojmë kritere të paqena në ligj për të mos përfituar një të drejtë që e njeh ligji, unë nuk e bëj. Tani, mbase prokurorët janë tek ajo pjesa e akuzës që mundohen dhe përpiqen për ta dënuar tjetrin. Unë jam tek pjesa që i vlerësoj gjërat më ftohtë. Nuk bëj as politikat penale të shtetit. Nuk kam lidhje të drejtpërdrejta as me organin e ndjekjes penale, as me policinë, as me institucion tjetër. Unë e vlerësoj. Në qoftë se vlerësoj dhe i shikoj gjërat me të njëjtin këndvështrim... Pastaj ta heqim gjykatën, se nuk ka se për çfarë duhet.

Në lidhje me lirimin me kusht të {...}s. Tani unë e kam thënë edhe këtu dhe nuk e kuptoj, është një faqe e ca që inspektori është munduar dhe ka bërë përlllogaritje të kohës së vuajtjes së dënimit që ka bërë personi. Unë kam pezulluar diku tek 4 muaj e disa ditë, por po e lë, po them 4 muaj, ndërkohë që inspektori thotë që “sipas përlllogaritjeve të mia është 7 muaj”. Pastaj një fjali më poshtë thotë “është administruar nga gjykata edhe një vendim me ulje dënimi 90 ditë”. Edhe e konstatojnë vetë edhe e sjellin si një rast, si shkelje. Unë nuk e di?!

Tani çfarë ka ndodhur gjatë gjykimit. Kur unë po shqyrtoja kërkesën “për lirimin me kusht”, një trup tjetër gjykues i gjykatës kishte vendosur uljen e dënimit me 90 ditë për 1 vit burgim që ky kishte kryer; dhe vendimi kishte marrë formë të prerë. Ishte i ekzekutueshëm. Ma paraqet gjatë gjykimit. Vendimi pra kishte marrë formë të prerë. Pra kishte kaluar afati 15 ditë i ankimit, e të gjitha këto. Unë e marrë dhe e aplikoj, dhe nga 7 muaj që ky kishte për të pezulluar, unë i kam ulur këtë 90-ditëshin dhe kam aplikuar 4 muaj. Kaq është.

Në vijim thuhet që vendimi është i paarsyetuar se nuk janë hedhur konkluzionet ose raporti i IEVP-së dhe i shërbimit të provës. Tani, arsyetimi i vendimit nuk është objekt shqyrtimi nga ILD-ja për sa kohë nuk është konstatuar nga një gjykatë me e lartë, sepse është tërësisht subjektiv. Jo vetëm që ai vendim është i arsyetuar sepse ne vendimet pak a shumë për çështje të ngjashme si strukturë i kemi njësoj. Po të shikosh vendimet që kam unë, ngre disa pyetje, disa çështje dhe pastaj nga përgjigjet e të gjitha çështjeve dhe në konkluzion. Por tek ky vendim unë nuk e kam hedhur të plotë ose të them raportin e

IEVP-së por kam thënë që referuar raportit të IEVP-së i cili është pozitiv, pro kërkesës së kërkesit, referuar raportit të shërbimit të provës që është pro kërkesës, si dhe fakteve të tjera dhe kam dalë me atë pjesën e konkluzionit. Tani quhet i paarsyetuar vendimi pse unë duhet të hedh... Po, dhe kam vendosur me “footnote” ose në kllapa që për më tepër e sheh edhe raportin e inspektimit, raportin e IEVP-së, më falni. Nuk e di që po të ishte shkruar kjo, që unë të hidhja të gjithë raportin...?! Kur ka pasur debat dhe unë kam bërë një arsyetim më të thelluar, e kam shkruar raportin më gjatë, kur nuk ka pas debate dhe të gjitha palët (siç kanë qenë në rastin konkret), të gjitha palët kanë qenë dakord, gjykata ka qenë dakord, vendimi... se këto janë të gjitha vendime të paankimuara, i njëjti prokuror po ka qenë dakord. {...} ka përfituar uljen e dënimit diku tek 4 muaj, aq sa i kishte ngelur, 4 muaj e disa ditë (siç është evidentuar aty), duke i llogaritur edhe atë 90-ditëshin që kishte përfituar ulje dënimi.

Tek rasti i {...}t, unë kam evidentuar që personi nuk arriti që të provonte në gjykim faktin që nuk kishte bërë një kërkesë të mëparshme e cila ishte rrëzuar nga gjykata brenda 6 muajve. Unë kam vlerësuar që detyrimi për të paraqitur prova e ka vetë pala, aq më tepër kur pala vjen edhe me avokat, edhe nga ato avokatët që duken edhe çfarë tipash janë edhe tek ankimi që bëjnë në apel, apo të lexosh ankimin, që lënë shumë për të dëshiruar në raport me sjelljen, si në gjykim ashtu edhe me gjykatën. Në rastet kur personat kanë ardhur vetë, s’kanë pas avokatë, atë ndjenjën e humanizmit dhe i kam orientuar në raport me paraqitjen e provave. Kurse kur vinë me avokatë pastaj jam tërhequr tek pozicioni im i vlerësimit të provave që më sjellin palët pa marrë rol aktiv. Këtë rolin aktiv të gjykatës nuk e kam përkrahur ndonjëherë se roli aktiv i gjykatës detyrimisht e bën të njëanshëm në varësi të çdo prove. Pasi personi nuk ka paraqitur atë provë që unë e kam vlerësuar që ishte e nevojshme dhe që ishte një shkak që nuk lejonte shqyrtimin në themel të çështjes (dhe nuk është një, janë edhe disa vendime të tjera, që unë mbaj këtë praktikë), kam vendosur “rrëzimin e kërkesës”. Kundër vendimit është bërë ankim në apel. Tani edhe Inspektori... se çfarë ndodh? Kur ka sjellë raportin e inspektimit, apeli ka shkruar një shprehje që ka thënë “shkelje procedurale, neni 477”. Por e lë me aq. Kjo çështje është përmendur shprehimisht tek raporti i inspektimit tematik në gjykata. Është përmendur shprehimisht kjo çështje. Aty thuhet që rezulton që gjykata e

apelit nuk ka bërë një arsyetim sepse është shkelur. Pra vetëm e ka thënë këtë, ka shkelje procedurale të nenit 477, por nuk e përmend.

Tek rasti im, e quan që gjykata e apelit paska gjetur një shkelje shumë të rëndë procedurale dhe e paska prishur vendimin tim... (e ka ndryshuar, po. Se prishja është kthim për rigjykim dhe ndryshimi është...) e ka ndryshuar vendimin tim dhe ka vendosur pranimin. Tani këtu ka gabuar gjykata e apelit. Tani unë kam qenë vetë. Ju më keni dërguar në gjykatën e apelit. Punova disa muaj. Mora eksperiencë dhe u ktheva prapë në shkallë të parë. Më vlejti shumë ajo eksperiencia dhe kam parë edhe se si gjykohet në gjykatën e apelit por edhe se si janë vendimet e gjykatës së apelit dhe sa detyrim më shumë se gjyqtari i shkallës së parë ka gjykata e apelit për të arsyetuar vendimet, se i ka të formës së prerë në qoftë se gjyqtari i shkallës së parë gabon, por mund ta ndreq në gjykatën e apelit, në gjykatën e apelit u ekzekutuan gjërat. Dhe vendimet e gjykatës së apelit janë ato që duhet të jenë të arsyetuara se mund të merren për bazë nga magjistratët e tjerë, siç u shpreh inspektorja kur sapo lexoi raportin, dhe mund të ndikojë tek magjistratët e tjerë. Jo vendimet e gjyqtarit të shkallës së parë.

Në rastin konkret ka gabuar gjykata sepse çfarë ka ndodhur? Po t'i referohemi procesverbalit, gjykata e apelit as nuk e ka riçelur fare hetimin gjyqësor, duhet ta kishte riçelur, pra edhe një shkelje tjetër kjo. Çfarë ka thënë? I ka kërkuar palës që të japi provën e munguar në shkallë të parë, pra atë që nuk e ka sjellë tek mua në shkallë të parë, i ka dhënë kohë palës për të çuar provën e munguar. Pra nuk kemi të bëjmë me shkelje procedurale. Po të jetë shkelje procedurale nuk ka nevojë për marrjen e provave të tjera. Shkelje procedurale, zbatohet drejt ligji procedural dhe ndryshohet vendimi ose prishet vendimi. Pra zgjidhet me vendim. Kanë kërkuar provën. Ka kërkuar kohë avokati. Ka vajtur ka marrë në sekretarinë e gjykatës provën e munguar, e ka paraqitur dhe mbi bazën e provës së munguar të paraqitur në gjykatën e apelit, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin tim dhe e ka pranuar kërkesën për "lirimin me kusht". Kështu që këtu nuk ka asnjë shkelje procedurale. Në qoftë se kjo provë do ishte e panevojshme dhe unë do ta kisha kërkuar në kundërshtim me ligjin, nuk kishte pse ta merrte gjykata e apelit. Kjo provë nuk ishte në dosje, kjo provë u kërkuar nga gjykata e apelit. Marrja e provave të reja nuk ka lidhje me shkelje procedurale. S'ka lidhje procedura me marrjen e provës. Kështu që gjykata e apelit këtu ka gabuar por si duket ky gabimi ndryshe çfarë është edhe

raporti i inspektimit më është atribuar mua, unë mendoj me të padrejtë. S'ka asnjë lloj shkeljeje këtu.

Brenda afatit të inspektimit ka pasur edhe shumë vendime të tjera që unë kam dhënë, vendime që vërtetë kanë diskutim, qoftë rasti kur një person kishte goditur me thikë bashkëjetuesen. Ishte dënuar për vrasje në tentativë. Plotësonte kriteret për lirimin me kusht. Ishte i padënuar dhe unë nuk e kam liruar sepse e kam quajtur person shumë të rrezikshëm dhe dhunën e ushtruar, ka qenë e rrezikshme mënyrë, telefonatat që ka bërë, pra dashja që e ka bërë. Pra nuk e kam liruar atë personin sepse kam menduar që ky është person që vazhdon të ketë rrezikshmëri, e shprehur qartësisht në mënyrën dhe në veprën penale që kishte kryer.

Pra nuk është ajo pjesë që unë nuk respektoj politikën penale. Aty ku duhet e kam respektuar. Ku nuk duhet, nuk bëhemi më fanatikë se Papa.

Është një vendim tjetër pastaj që është aplikuar një masë sigurimi, një masë 7-vjecare dënimi, që personi nuk mund të përfitonte nga lirimi me kusht. Është kërkuar të futet periudha e përfituar me amnisti. E kam hequr këtë periudhë sepse ligji e parashikonte shprehimisht, pra kam respektuar drejt pjesën procedurale/ligjin procedural, dhe e kam rrëzuar kërkesën. Domethënë janë 3-4 vendime që unë ia kam sjellë për të referuar.. Mua më bëri çudi se këto vendime kanë qenë e kësaj periudhe inspektimi. Pse nuk janë parë? Pse nuk janë përmendur? Këto mund të kenë më shumë diskutime se këto të tjerat.

Thoshte mirë një gjyqtar atje te ne që: “Po le në burg, nuk të thotë gjë njeri, po shiko mos nxjerr ndonjë, se t'u qep me ... nga mbrapa”. Tani unë jam i tillë gjyqtar. Unë jam edhe besimtar dhe po flas kështu me dorë në zemër. Më ka këshilluar një njeri shumë i mençur dhe më ka thënë: - “Kurrë mos ki frikë nga e drejta”. Dhe unë të drejtën personit po e pati, do t'ia jap me çdolloj kushti, se ndryshe nuk e pranoj dot. Kur kemi bërë, ditën e fundit që kam lënë detyrën e drejtuesit të gjykatës në 2022, është bërë analiza e vitit 2021. Në Gjykatën e Gjirokastrës ishin dhënë 24 pafajësi, përtej pushimeve, nga këto, 19 i kisha dhënë vetëm unë. Unë jam i tillë gjyqtar. Personi po pati të drejtë dhe po e njohu me ligj, unë nuk tremben se do jem këtu sot, mund të kem një vendimmarrje shkarkimi, ose mund të vij nesër prapë. Për sa kohë kam bërë betimin me dorë në zemër që do të respektoj Kushtetutën, unë do respektoj Kushtetutën. Kush ka të drejtë do ta përfitojë

të drejtën siç e ka ligji. Frikë në zbatimin e ligjit unë nuk kam, kështu siç e kam zbatuar edhe në të gjitha rastet konkrete.

Gjëja më e lehtë në gjykimet e mia është të marrësh të drejtën dhe të gjithë ata të dënuar që e kanë pasur këtë të drejtë, e kanë marrë, në mënyrë absolute. Por të eci dhe të gjykoj me frikën që shiko se po e lirova unë, do shkruaj policia; po do vete Inspektori; politika penale; ose dolën mediat dhe folën kështu; unë më mirë e lë këtë punë që sot, nuk e vazhdoj më, por unë i tillë gjyqtar nuk bëhem.

Nuk kam gjë tjetër, mos të zgjatem më, se besoj i thashë të tëra. Iu referova atij raportit. Unë mendoj që nuk ka shkaqe, nuk ka pas shkaqe për të filluar fare ky procedim disiplinor dhe nuk shoh asnjë shkak për të vendosur një masë disiplinore ndaj meje, aq më tepër masën më maksimale që parashikon, atë të shkarkimit. Të gjitha vendimet nuk kanë asnjë lloj shkelje.

Domethënë, inspektorja e nderuar tha që ka shkelje, është precedenti, e është kjo. Unë nuk e kuptoj, kush është një shkelje, një shkelje. Le të më thotë, të marri fjalën dhe të më thotë kush është një shkelje që unë e kam kryer. Por tek pjesa e arsyes së veçantë, tek vlerësimi i provave, ju lutem shumë të mos ndërhyjë, sepse inspektorët e dinë shumë mirë punën e tyre, i dinë shumë mirë kompetencat e tyre. Kanë shkelur kompetencat, kanë ndërhyrë atje ku nuk u takon, siç nuk kanë ndërhyrë dhe nuk vlerësuar në raportin e inspektimit tematik.

Kështu që duke ju falënderuar shumë për dëgjuesën, unë do të kërkoja rrëzimin e kërkesës së Inspektorit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit magjistrat {...}!

Do të ftoja anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përfaqësuesit e ILD-së nëse kanë pyetje të ndërsjella apo jo për sa u parashtrua.

Po zonja Muçaj!

Gentiana Muçaj: Unë kërkoj nga inspektorët që për çdo vendim që ju keni inspektuar, të më konkretizoni, të më bëni analizë të shkeljeve, në referim edhe të nenit 64. Domethënë, marrim të parin, {...}. Konkretisht kë parashikim të nenit 64 ka shkelur gjyqtari? Për çdo vendim.

{...}: Janë në raport.

Gentiana Muçaj: Jo, jo. Nuk janë në raport.

{...}: Siç e tha edhe magjistrati, është aq i detajuar, sa është hyrë edhe në llogaritje. Unë i bie të lexoj raportin.

Ilir Rusi: Ju lutem zoti {...}.

Ju lutem, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor zonja Muçaj ka marrë fjalën dhe po parashtrohet kërkesat e veta ndaj jush. Dëgjojeni dhe në një moment të caktuar kur të përfundojë zonja Muçaj, mund të ndërhyni për të folur.

Gentiana Muçaj: Kush janë shkeljet e nenit 64 tek {...}, tek ulja e dënimit, tek lirimi me kusht i {...}, dhe tek dy të tjerat? Në analizimin e elementit të shkeljes, të dy shkeljeve që ju pretendoni që janë kryer nga magjistrati. Sepse unë e kam lexuar me shumë vëmendje raportin dhe nuk gjej as gjëkund një referim të nenit 64.

{...}: Raporti është për nenin 64.

Po pra, unë po përgjigjem pyetjes suaj.

Ilir Rusi: Po fjala për ju zoti {...}!

{...}: Atëherë, i gjithë raporti është për nenin 64, dhe në vlerësimin e ILD-së, siç është konstatuar në raport, këto raste nuk duhet të ishte lejuar fare lirimi me kusht, për ato shkelje që janë përmendur në raport.

Po pra, {...} është rasti kur ai ka qenë i dënuar më parë. *(i përgjigjet zonjës Muçaj e cila flet pa ndezur mikrofonin.)*

Jo, nuk është i rehabilituar. *(i përgjigjet zonjës Muçaj e cila flet pa ndezur mikrofonin.)* Është rasti që është dënuar më parë për kundravajtje, që siç e theksoi edhe magjistrati dhe ne vetë e kemi përmendur në raport që dënimi për kundravajtjen nuk

është kusht ndalues që parashikon neni 64/3 i Kodit Penal, por në bazë të orientimeve të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë të 2015, të gjitha këto rrethana merren parasysh në vlerësimin e personalitetit të personit nga gjykata, pra në tërësi për të vendosur ose pranuar kërkesën “për lirim me kusht” dhe duke i vlerësuar këto rrethana, ky person nuk duhet të përfitonte nga lirimi me kusht, shkak që është bërë edhe ankesë në ILD nga personi i dëmtuar prej këtij personi.

Gentiana Muçaj: Kush është shkelja e nenit 64 që ka kryer? Ligji material procedural që ka passjellë përfitim të padrejtë ose dëm. Këto janë. Mosveprimi i kundraligjshëm magjistratit që sjell një përfitim të padrejtë për të dënuarin. Në rastin konkret, pavarësisht se neni 64 nuk e parashikon si kusht ndalues lirimin e të dënuarit për kundravajtjen administrative, gjyqtari duhet të analizojë të gjithë tërësinë e çështjes për të parë që ky meqenëse qenka kundravajtës, ka bërë një kundravajtje penale, ky nuk duhet të lirohet. Kjo! Ku është shkelja?

{...}: Kjo është shkelja pra. Sepse kushtet objektive janë shumë të qarta për t’u përmbushur nga personi që ka bërë kërkesën “për lirim me kusht”, ndërsa në këtë pjesë, që është, po themi kushtet subjektive të lirimit me kusht është e gabuar, dhe ky person nuk duhet ta përfitonte lirimin me kusht në këto rrethana.

Tek shtetasi {...} është ...

Ilir Rusi: Ju lutem, të identifikojmë ndërveprimin mes jush në raport me pyetjet dhe përgjigjet.

Deri më tani nga zonja Muçaj është shtruar një argument i analizës. Nga inspektori në lidhje me {...}. Tashmë zonja Muçaj po parashtron një situatë në lidhje me një rast tjetër, që ka të bëjë me z. {...}, që tek relacioni lidhet me uljen e dënimit apo me lirimin me kusht?

Gentiana Muçaj: Tek ulja e dënimit, kush është shkelja?

{...}: Siç është sqaruar edhe në raport, analiza e vendimit bazohet në ligjin e shfuqizuar, pra të gjitha kriteret që janë përdorur në analizë janë të ligjit të shfuqizuar, ndërsa citimi është neni 75 i ligjit të ri 83/2020. Pra po të shikosh vendimin, të lexosh vendimin, kriteret që janë përdorur për të përfituar uljen e dënimit janë të nenit 63 të ligjit 98 të shfuqizuar, nuk janë të nenit 75 të ligjit të ri, që e ka shfuqizuar atë ligj. Kjo është shkelja.

Gentiana Muçaj: Tek ulja e dënimit ju thoni që mungon vlerësimi i bërë nga IEVP-ja?

{...}: Është përdorur vlerësimi që është për kërkesën “për lirim me kusht”.

Gentiana Muçaj: Vlerësimi thotë ulje dënimi, data 20.09.2021. Kërkesa 13.09.2021.

Po në dosjen e paraqitur nga gjyqtari. Nuk e di, e keni pasur ju? E keni vlerësuar?

{...}: Jo, nuk e kemi pasur në dispozicion në fakt.

Gentiana Muçaj: Si? Ka qenë në dosje.

{...}: Unë kujtoj që nuk e kemi pasur.

Gentiana Muçaj: Vlerësim për “ulje dënimi”, 20.09.2021.

{...}: Dakord! Po nuk besoj që kjo është e rëndësishme në lidhje me vendimin e uljes së dënimit.

Gentiana Muçaj: Pse, kush është e rëndësishme?

{...}: E rëndësishme është arsyetimi që është përdorur, sepse me ligjin e ri kërkuesi nuk i plotëson kriteret, kriteret që parashikon neni 75 i ligjit të ri.

Gentiana Muçaj: Shkelja tek çështja e {...}.

{...}: Është aplikimi gabim i dispozitës domethënë i kriterit objektiv i ligjit material, pra neni 64 ku magjistrati në vend të aplikojë 3/4, sipas vlerësimit të Inspektorit të ligjit, të masës së dënimit që duhet të ketë vuajtur kërkuesi, ka aplikuar 2/3 e dënimit të dhënë, pra duke zbatuar mbi dënimin e dhënë nga gjykata dhe jo mbi parashikimin e dispozitës. Ndërkohë që vetë praktika e magjistratit, pavarësisht asaj që tha këtu është tek 3/4. Meqenëse ne na ka rënë rasti gjatë këtij hetimi disiplinor dhe ndaj inspektimit tematik që u përmend, praktika e magjistratit është që zbaton drejt, pra 3/4, duke iu referuar parashikimit të dënimit që ka dispozita, siç është i qartë edhe vetë neni 64, pavarësisht praktikave që zbatohen sot në gjykata që ne i kemi konstatuar nga inspektimi tematik, neni 64, në vlerësimin tonë, është i qartë. Pra në aplikimin e marzhit të dënimit të vuajtur, 2/3 apo 3/4, kjo dispozitë i referohet parashikimit që ka dispozita dhe jo dënimit të dhënë nga gjykata. Kjo është praktika që ka ndjekur dhe vetë magjistrati në vendimet e tij. Ndërsa këtu është e ndryshme.

Gentiana Muçaj: Po tek {...}, kush është shkelja?

{...}: E njëjta gjë është.

Gentiana Muçaj: Po tek {...}?

{...}: Tek {...} është konstatimi nga gjykata më e lartë, meqenëse edhe magjistrati vetë e përmendi dhe pastaj në kundërshtim me atë që tha më parë e atakoi vendimin e gjykatës më të lartë dhe gjykata më e lartë është shprehur që nga ana e gjykatës së shkallës së parë ka një keqinterpretim të dispozitës procedurale, neni 477/2 të K.Pr.Penale në lidhje me këtë rast. Pra është vendimmarrja në kundërshtim dhe keqinterpretim të kësaj lloji dispozite.

Gentiana Muçaj: Sikur s'ë thotë ashtu.

{...}: Unë thashë, po t'i lexoj në raport, t'i lexoj tekstualisht. Unë po i them... E thotë fjalë për fjalë kështu siç e thashë unë madje, siç e citova unë, pa e parë në raport. Dhe gjykata e apelit kështu e thotë, në kundërshtim dhe keqinterpretim të kërkesave të nenit 477 të K.Pr.Penale. Pa atë dyshin që e shtova unë këtu. Është më e saktë dyshi.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçaj!

Atëherë fjala për zonjën Plaku.

Irena Plaku: Atëherë, pyetja e parë është lidhur me praktikën tuaj në rastet e lirimit me kusht, cilën praktikë ndiqni, pra aplikimin 3/4 apo 2/3? Sepse thatë që gjyqtarë të ndryshëm, referuar atij raportit që ka bërë edhe ILD, kanë ndjekur praktika të ndryshme. Ju vetë çfarë praktike keni? Po, për masën e dënimit. Zbatimin e 3/4 apo 2/3? Kur aplikoni 3/4 dhe kur 2/3? Domethënë si e bëni ju, të paktën në praktikën tuaj?

{...}: 2/3 ose 3/4 duhet të llogariten mbi masën e dënimit të dhënë. Unë kur e kam zbatuar në rastin konkret edhe tek {...}, ndryshe nga ç'thotë Inspektori, e kam zbatuar me 3/4. Pra tek {...} po t'i referohesh...

Irena Plaku: Po ju pyes, praktikën tuaj si e zbatoni ligjin në rastin e lirimit me kusht? Çfarë praktike ndiqni? Domethënë kur zbatoni 2/3 dhe kur zbatoni 3/4? Si e bëni diferencën me pak fjalë?

{...}: Kjo është ajo që kam në mendje. Pastaj duhet t'i shikoj të gjitha këto tani. Ajo që unë kam në mendje, që duhet të zbatohet në lidhje me masën e dënimit, si ka thënë edhe Gjykata e Lartë.

Irena Plaku: Domethënë ju e zbatoni në bazë të masës së dënimit të dhënë? Është pyetje dhe dua ta konfirmoj.

{...}: Po! Kjo është.

Irena Plaku: Ok! Në rregull.

Domethënë në bazë të dënimit të dhënë, për shembull është dënuar 5 vjet ($2/3$ e 5 vjetëve), është dënuar 7 vjet ($3/4$ e 5 vjetëve), apo jo?

{...}: Në gjykatën tonë ka pasur çështje, ka qenë me muaj.

Tani po të shikosh 3 muaj...

Irena Plaku: Nuk dua shembuj.

Unë po them praktikën tuaj.

{...}: Në gjykatën tonë kjo nuk është diskutuar kurrë.

A ta them të lutem? Ta thashë praktikën time. Ta thashë që unë kam këtë qëndrim. Tani praktika ime e tillë, ma dëgjo të lutem. Nuk është diskutuar kurrë $2/3$ apo $3/4$, se bëhet fjalë për 2 muaj e për 3 muaj. Dhe $2/3$ nga $3/4$ ndryshojnë me ditë. Dhe të gjithë kur ne kemi shpallur vendimet, të gjitha vendimet po t'i marrësh e t'i shikosh këtu, të gjithë e kanë kryer mbi $3/4$ e dënimit sepse nga momenti që fillonte që paraqitej kërkesa derisa ajo ndryshonte me $2/3$ me $3/4$, se nuk ka pasur dënime me burgim të përjetshëm me nga 20 vjet, nga 10 vjet. Unë ju thashë, 2 muaj, 3 muaj, 4 muaj dhe $2/3$ me $3/4$ nuk kanë fare... pra nuk është shtruar në diskutim kjo. Dhe të gjitha këto që janë këtu, po t'i llogarisim... Ky është një debat që unë e hapa vetë, se unë mund të them shumë mirë, hajde t'i llogarisim të gjitha këto. Të gjitha janë me $3/4$ këto. Të gjitha janë me $3/4$. {...} që thotë inspektori është me $3/4$, por ka një gabim material në fund tek ajo pjesa që, ne e lamë, do të thotë që u plotësua kriteri i $2/3$. Por po të shikosh llogaritjen, se unë kam bërë llogaritjen lart, kam llogaritur datën, pra llogaritjen e llogaritjes që bën IEVP-ja tek fleta që sjell ajo, unë kam llogaritur, {...} e kam llogaritur me $3/4$. Prandaj thotë inspektori që ka pasur praktikën me $3/4$. Po! E doni $3/4$. Po, e kam pasur $3/4$. Se hapa një debat për...

Ilir Rusi: Zonja Plaku regjistroje pak të lutem.

Irena Plaku: Pyetja ime është pikërisht atë që thatë ju. Praktikën tuaj. Praktikën tuaj, si e zbatoni në të gjitha rastet. Çfarë praktike keni ndjekur lidhur me zbatimin e 2/3 apo 3/4 lidhur me masën e dënimit? Si e keni aplikuar ju? Dhe një mendim tjetër i imi është. Në rast se unë për shembull do vendosja 2/3, do thoja po, në këtë rast do zbatoj 2/3. Apo jo? Se thuhet në vendim ajo. Në këtë rast, për këtë lloj masë dënimi do zbatoj 2/3. Në këtë rast, duke qenë se, pasur parasysh praktikën (po ta bëj si shembull), pasur parasysh që ky ka këtë masë dënimi, -po, unë do aplikoj 3/4 referuar 64-ës. Prandaj po pyes, kush është praktika juaj, praktika juaj në të gjithë vendimmarrjet tuaja.

{...}: Po më duhet të shoh vendimet, një për një.

Atëherë, të gjitha vendimet.

Më fal pak. Më fal pak.

Në momentin e shpalljes së vendimit...

Inspektori është në rregull. 3/4 e kam unë. Siç e do inspektori, ashtu më dalin vendimet.

Jo, jo, siç e do inspektori, se inspektori nuk ka të njëjtin mendim tek inspektimi tematik.

Irena Plaku: Të lutem. Të paktën siç e dëgjova unë inspektorin, tha që ka pasur praktika të ndryshme vetë gjyqtari, apo jo?

{...}: Citoj edhe një herë atë që thashë.

E thashë, gjatë këtij inspektimi, hetimit disiplinor dhe inspektimit tematik që kemi pasur njëkohësisht, unë kam pasur mundësi të njihem me praktikën e magjistratit dhe kam konstatuar që ka praktikën 3/4, pra i referohet parashikimit të dispozitës, që në vlerësimin tonë ose timin, në vlerësimin tim po e them, jo të inspektorit, është zbatimi i drejtë, pra duke iu referuar parashikimit në dispozitë siç edhe vetë neni 64 e ka të shprehur. Nuk ka vend aty për ngatërrim.

{...}: Një sekondë.

Nuk e përcakton ti inspektor. E përcakton gjykata. Ti i bindesh gjykatës.

{...}: Po flas për vlerësimin tim.

Siç keni ju vlerësimin tuaj, unë kam vlerësimin tim.

{...}: Po pse s'e ke dhënë vlerësimin tek inspektimi tematik?

{...}: Më falni se po vazhdoj, është përmendur gjatë gjithë parashtrimeve të magjistratëve inspektimi tematik. Inspektimi tematik është një inspektim i gjatë 3-vjecar i vendimeve gjyqësore të të gjitha gjykatave. Është një inspektim i përgjithshëm ku kanë marrë pjesë të gjithë inspektorët dhe është bërë vetëm mbi vendime gjyqësore, nuk është bërë mbi dosje, pra që të kalojmë në shkelje individuale. Nga indiciet që janë marrë nga ai inspektim tematik, pastaj Inspektori ka kaluar edhe në verifikime të shkeljeve individuale ose inspektimeve individuale. Ndërkohë që hetimi për magjistratin ka qenë paralelisht, pra kishte filluar proces verifikimi dhe më pas hetimi. Pra nuk ka të bëjë inspektimi tematik ose përfundimet e përgjithshme që janë dhënë aty dhe jo mbi inspektime individuale sepse ndryshe do ishin përmendur. Nuk ka të bëjë fare me rastin e hetimit që kemi përpara, se ka qenë paralelisht, ishte i filluar ndërkohë që atje kishte edhe vendime të magjistratit që kishte dhënë dhe prandaj thashë që jemi njohur me praktikën e tij që zbatohet kështu nga vetë vendimet gjyqësore që janë lexuar. Pra nuk ka pasur dosje, ka pasur vetëm vendime dhe nga kjo kuptohet kjo lloj praktike që unë e përmenda.

{...}: Mundem unë?

Kë kam aplikuar unë tek {...}, 2/3 apo 3/4?

{...}: Po është në raport.

{...}: Po si s'e mban mend?

Me leje? Mund të referoj diçka.

Ky është vendimi i {...}, lirimi me kusht.

Ka një rubrikë dhe them këtu "...Në interpretim të dispozitës së mësipërme..." dhe është ky neni 64, "...gjykata vlerëson që nga kërkuesi duhet të plotësohen

kumulativisht këto kushte: 1. Të ketë kryej jo më pak se 3/4 e dënimit të dhënë...”. Pra s’paskam aplikuar 2/3 unë. “2. Të mos jetë përsëritës për krime të kryera me dashje dhe ato që janë të ndaluara; 3. Ekzistenca e arsyeve të veçanta nëse në sjellje [...] tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij.”

Në lidhje me kushtin e parë, -them, -gjykata konstatoi se kërkuesi {...} me vendimin nr. “kaq”, datë “kaq” të rrethit gjyqësor Sarandë është dënuar me 5 vite burgim për veprën 283/2, lënë në fuqi. Kërkuesi është arrestuar në datën 24.11.2018, deri në ditën e dhënies së këtij vendimi i ka mbetur pa vuajtur 1 vit e 21 ditë burgim. Në këto kushte kërkuesi plotëson kriterin (këtu kam gabuar unë dhe them) të 2/3 së dënimit. Ka ngelur nga vendimi i mëparshëm. Por 3/4 e dënimit, po duam edhe e llogarisim, se tek raporti që ju kam sjellë, tek kundërshtimet e kam llogaritur. Në qoftë se do ishte me 2/3, ai do kishte kryer 5 muaj dënim më tepër. Se ky është i vetmi rast.

Nëse do më jepni vetëm një minutë kohë, unë e kam llogaritur edhe këtu, që pse s’e kam bërë me 2/3. Pra ky është lapsus. Ky është gabim material.

{...}: ...një kriter objektiv s’mund të bëhet lapsus sepse ndikon.

{...}: Prokuror!

{...}: Më fal, s’dua të bëj debat.

{...}: Jo, bëjmë debat ne, se ti më ke sjellë këtu. Si s’do bëjmë debat?!

Ti s’mund të vish këtu të flasësh në mënyrë të përgjithshme kur je dhe profesionist. Se po të mos jesh profesionist jam dakord. Si mund të vish të flasësh në mënyrë të përgjithshme dhe të thuash janë shkelur kriteret...?!

{...}: Unë nuk thashë që në fund ata s’e kanë plotësuar marzhin e dënimit të vuajtjes si me 2/3...

{...}: E kanë plotësuar apo jo?

{...}: E kanë plotësuar.

{...}: E kanë plotësuar. Jemi në rregull pastaj.

{...}: Si me 2/3, si me 3/4.

Me 2/3. Ndërkohë që duhej zbatuar 3/4.

Po të lexosh vendimin... Unë po flas çfarë ka vendimi dhe dosja. Pra magjistrati shprehet që ka plotësuar 2/3.

{...}: Po tani, ajo që unë kam pezulluar, i referohet 2/3 apo 3/4?

{...}: Ju keni zbatuar kriterin 2/3. Ndërkohë që duhet të zbatonit 3/4.

{...}: Jo more zotëri, kam thënë 3/4 unë këtu. E kam thënë 1 vit e 21 ditë. 1 vit e 21 ditë i korrespondon kriterit të 3/4, jo të 2/3. Pastaj juve jeni munduar keni bërë përlllogaritje, jeni lodhur aty. Pse s'e bëre edhe këtë përlllogaritje ta shikoje që është aplikuar 3/4 dhe jo 2/3?

{...}: Po e thashë që në fund ai e ka plotësuar si 2/3 si 3/4. E thënë ndryshe, ka rastisur që e ka plotësuar.

(Fjala i jepet zonjës Plaku, por fjalën e merr zonja Luli.)

Fatmira Luli: Keni evidentuar ndonjë shkelje të hapur që ka sjellë pasoja të rënda në cenimin e të drejtave.

Ilir Rusi: Zonja Luli, zonjës Plaku i është dhënë fjala.

Ju lutem, meqenëse shikoj që anëtarët i kanë lexuar materialet dhe kanë një ndërveprim, dhe disa marrin fjalën në të njëjtën kohë. Zonja Luli, po, çfarë kishit për të thënë?

Fatmira Luli: Po e përsëris.

Pyetja ishte: Shkeljet e konstatuara a kanë sjellë pasoja në dëmtimin e interesave të shtetasve ose në dëm të kundërt kur ato duhet të vuanin dënim më shumë dhe padrejtësisht janë lëruar para kohe? Pasoja që parashikon ligji. Sepse gjithmonë në këto raste, me të drejtës së gjyqtarit për të interpretuar dhe arsyetuar vendimin si e gjykon ai dhe shkeljes së bërë, shkeljes së ligjit material dhe procedural për të cilat ne kemi gjykuar edhe gjyqtarë të tjerë, kanë një vijë ndarëse, e cila asnjëra s' duhet të interferojë tek tjetra. E drejta e gjyqtarit është të interpretojë ashtu siç e mendon ai. Nëse ai shkel ligjin në mënyrë të hapur dhe kjo është konstatuar nga një gjykatë më e lartë ose ai në mënyrë të hapur ka dëmtuar interesat e shtetasve në procesin penal, atëherë kjo evidentohet në këto procedime disiplinore. Dhe këtë pyetje kisha. Është evidentuar një dëmtim i interesave të shtetit ose të shtetasve në këtë proces për shkak të veprimeve që ka bërë gjyqtari?

Ilir Rusi: Fjala për ju përfaqësues i Inspektorit.

{...}: Në përgjigje të pyetjes suaj, ne i referohemi gjithmonë shkeljes disiplinore për të cilën është proceduar disiplinarisht magjistrati që është ajo e përfitimit të padrejtë të palëve në një proces gjyqësor, që në këtë rast, siç e kemi vlerësuar ne, përfitimi i padrejtë është në përfitimin e vetë lirimit me kusht. Pra nga gjithë ato konstatime që ne kemi nxjerrë në raport, kjo është pasoja e ardhur. Nuk presim ndonjë pasojë konkrete pasi lirohet ai me kusht.

Fatmira Luli: Sapo thatë që ka aplikuar 3/4, domethënë ka aplikuar standarde

{...}: Thashë, ka aplikuar 2/3, ndërkohë që duhet të aplikojë 3/4.

Fatmira Luli: Po thatë që lirimet janë bërë me 3/4. Kjo ishte fjalia e fundit.

Domethënë, të tërë personat që janë liruar para kohe me kusht, në fakt kanë aplikuar me 3/4, jo me 2/3, pavarësisht lapsuseve që ka në vendim që citohen të dyja.

{...}: Unë nuk po flas është lapsus apo jo. Unë po flas çfarë kemi konstatuar dhe kemi lexuar në vendimet gjyqësore. Pavarësisht se në fund, po të bësh llogaritjet ai i ka

plotësuar edhe me 3/4. Por e supozojmë se në një rast nuk do ta kishte plotësuar me 3/4 dhe do ishte i liruar me 2/3 (ndërkohë që s'i ka plotësuar me 3/4), atëherë a është zbatuar gabim këtu, a ka shkelje të nenit 64?

Po pra që ka përfituar pa të drejtë një person është liruar me kusht, janë zbatuar 2/3, kur me 3/4 ai nuk do lirohej. Kjo është ideja.

Gentiana Muçaj: (Teknikisht e padëgjueshme audio e znj. Muçaj).

Kush është shkelja tek rasti i {...}?

{...}: Zbatimi i gabuar i ligjit material.

Gentiana Muçaj: I kujt? Nenit?

{...}: Nenit 64, paragrafi i parë.

Gentiana Muçaj: Ju lutem. Neni 64, paragrafi i parë që ju pretendoni që magjistrati ka aplikuar 2/3, ndërkohë që duhet të aplikonte 3/4. Kjo është?

{...}: Po!

Pastaj pasojën e gjejnë cila është, është konkrete apo s'është konkrete, apo është në termin e përgjithshëm që është përfitimi i padrejtë i lirit me kusht.

Gentiana Muçaj: Pasoja duhet të jetë konkrete apo hipotetike?

{...}: S'po them hipotetike.

Gentiana Muçaj: Ajo që ju i kthyet përgjigje zonjës Luli, unë kështu e kuptova, si hipotetike. Domethënë ky përfitimi i padrejtë ose ky dëmi i shkaktuar duhet të jetë konkret, konkret duhet të jetë, veprimi-pasoja. Flasim për lidhje shkakësore.

{...}: Po konkret po flasim, se bëhet fjalë për lidhje shkakësore, prandaj po themi konkret.

Gentiana Muçaj: Edhe një herë. Është zbatuar 2/3, ndërkohë që duhet të zbatohet 3/4. Dhe kush është shkelja? Domethënë atij s'i takonte të dilte.

Ilir Rusi: Po {...} Luli!

Fatmira Luli: Atëherë është shumë e rëndësishme që ne të ndajmë këtë lloj përgjegjësie dhe këtë lloj detyrimi edhe të ILD-së në raport me kontrollin por edhe të drejtës së gjyqtarëve, se po e cenuam këtë vijë të kuqe, ne kemi ndërhyrë në pavarësinë e gjyqtarëve; po ashtu edhe nëse ne nuk godasim ato shkelje, kemi abuzuar me të drejtën tonë. Prandaj është shumë e rëndësishme të eidentojmë saktë shkelja konkrete që është dhe pasoja që ka ardhur nga këto shkelje. Në të kundërtën ne ngelemi në një arsyetim që ka të bëjë vetëm me probleme vlerësimi etiko-profesionale, që këto janë shkelje për vlerësimin e gjyqtarit dhe nuk kapin kurrë rëndësinë e një shkeljeje disiplinore.

{...}: Në fund të asaj që sapo thatë ju, për të mos cenuar atë vijën e vlerësimit, unë mendoj që Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë këtij procesi i ka zbatuar ato parime që kërkon vetë ligji 96, siç janë “të paanësisë”, “të barazisë”, “të pavarësisë së magjistratit”, sepse në disa vendimmarrje të tjera që janë përmendur në raport, shumë shkurt, por janë 2 rrezime dhe 4 kërkesa pranimi të lirimit me kusht, nga Inspektori është konstatuar se s'ka asnjë lloj problematike në lidhje me zbatimin e nenit 64. Pra mendoj se e ka bërë këtë ndarje. Në ato që është konstatuar, siç është përmendur në raport, janë eidentuar ashtu dhe janë sjellë këtu.

Ilir Rusi: Në vijim, po zonja Plaku keni kërkuar fjalën.

Irena Plaku: Një pyetje tjetër lidhur me një vendim gjyqësor që u citua nga ana juaj (s'po e mbaj mend emrin e palës) ku Inspektori kishte bërë një llogaritje të vetën dhe kishte thënë që nuk është llogaritur mirë, në fakt 4 muaj e 8 muaj. Ju thatë që i dënuari

kishte edhe ulje dënimi. E keni llogaritur uljen e dënimit juve? Domethënë nga ana juaj është llogaritur ulja e dënimit, që më pas ka dalë ajo masë dënimi e mbetur më pak?

{...}: Po sigurisht.

Deri në momentin pa paraqitur kërkesën kishte 7 muaj e pak ditë.

Irena Plaku: Domethënë është shkruar në vendim kjo gjë?

{...}: Po sigurisht që është shkruar. Edhe Inspektori e shkruan, pavarësisht se çuditërisht e përmend në raport.

Irena Plaku: Në rregull.

{...}: Atëherë, mund të bëj edhe unë një pyetje? E bëri edhe {...} e nderuara anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, që në rastin e {...} është marrë edhe një vendim ulje 90 ditë. Atëherë pse nuk është llogaritur derisa në vendimin...

{...}: Po pse s'e kape ti këtë?

{...}: Meqenëse na u dha e drejta nga drejtuesi i seancës që mund të bëjmë edhe pyetje njëri-tjetrit.

U citua posaçërisht vendimi i uljes së dënimit. Atëherë përse nuk është llogaritur në lirimin me kusht?

{...}: Tani kjo nuk është një pyetje "fair" kur i thonë, se këtë unë e ngrita vetë.

{...}: E kemi nxjerrë edhe ne.

{...}: Jo, s'e ke nxjerrë.

E ke thënë atje, por nuk e quan shkelje. Se po ta quash shkelje këtë, të bie gjithë ajo struktura që ke ngritur, që unë me vendimmarrjen time jam munduar që, që nga

kërkesa e parë për pushim, që nga shorti, që nga ulja e dënimit, që nga lirimi me kusht, kam bërë gjithçka për të ndihmuar {...}. Pra të bie kjo.

{...}: A jeni dakord ju që në momentin që ka paraqitur kërkesën e dytë nuk i plotësonte kohën e vuajtjes së dënimit?

Ilir Rusi: Zoti {...} ju po flisni por po flisni me veten tuaj sepse nuk po regjistrohet. Ndërveprimi juaj është në raport me argumentet dhe jo në raport me çështjet të cilat kanë të bëjnë me thelbin e gjykimit, e procedimit disiplinor. Çështjet të cilat përderisa ju i keni prezantuar pranë Këshillit do të thotë që duhen ezauruar dhe gjykuar, ndërveprimi juaj është në raport me argumentet të cilat parashtrihen gjatë kësaj seance dëgjimore. Për sa janë parashtruar me shkrim, ne i kemi me shkrim, dhe për sa janë të prezantuara në mënyrë verbale, mund të ndërveproni por brenda kufijve të ndërveprimit përkatës.

Po, zoti {...}, fjala për ju!

{...}: Këtë thashë, që është gabim i imi dhe unë e kam harruar t'ia llogaris. Pra atij nuk do t'i ulej 1 vit e 1 muaj sa i është ulur, por duhet t'i zbritet edhe ai 90-ditëshi. Por ajo që mua më bën përshtypje është që si shpjegohet që inspektorët kanë qenë kaq të detajuar, ka të vëmendshëm për të gjetur edhe gabimet materiale në vendim, por këtë nuk e paskan konstatuar si shkelje. Sepse po të konstatohej kjo si shkelje, e gjithë ajo ngrehinë që ishte bërë, pra e gjithë ajo që ishte sjellë që {...} ishte favorizuar dhe liruar në mënyrë të padrejtë, binte.

Sa i përket pyetjes që në momentin që {...} ka paraqitur kërkesën plotësonte 3/4 ose jo, e ka vlerësuar inspektori, e kam vlerësuar edhe unë tek masa që i kam ulur. Në momentin që ka paraqitur kërkesën (unë e kam shkruar tek raporti por çuditërisht nuk po e gjej dot) plotësonte 2/3. Për 3/4 donte edhe 8 ditë. 18. Donte 18 ditë. Mua më del 8 më duket, por dakord, mbase gabohem. Donte edhe 18 ditë në momentin që ka paraqitur kërkesën në 12.09.2021, donte dhe 18 ditë. Por të gjitha vendimet që unë kam dhënë, të gjitha vendimet e Gjykatës Gjirokastër duhet të jenë mbi 90% e vendimeve (se unë i kam lexuar tek raporti tematik, por edhe një vendim i Gjykatës së Lartë i përmendur prej

meje dhe është edhe në raportin tematik) dhe e gjithë praktika gjyqësore është që ne nuk e bëjmë llogaritjen nëse ai ka kryer 2/3 ose 3/4 në momentin e paraqitjes së kërkesës, por në momentin kur shpallim vendimin dhe kur është shpallur vendimi ka plotësuar {...} ¾ e masës së dënimit të dhënë nga gjykata ose që parashikonte ato... dhe kjo është evidentuar qartë. Nuk e di pse duhet të ndodhte që unë duhet t'ia kisha rrëzuar që në fillim?! Se do ishte ndryshe me të gjithë praktikën time, ose e të gjithë gjykatave (e Gjykatës së Lartë, inspektimit që është evidentuar).

Ilir Rusi: Mirë zoti {...}, faleminderit!

Ka ndonjë diskutim apo pyetje nga anëtarët?

Po, zoti {...}!

{...}: Meqenëse u përmend edhe nga magjistrati, pra u përmendën disa pika të kontekstit procedural, pra siç ishte afati i parashkrimit që u pretendua në lidhje me dy çështje, pra atë të {...} dhe {...}, duke iu referuar disa dispozitave që ka ligji 96/2016 i ndryshuar, siç është neni 126 “pezullimi i hetimeve” dhe neni 117, neni 134, neni 139, pra që janë mbyllja e hetimit ose mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, në të gjitha këto rastet, të cilat këto dispozita po t'i shikosh janë në një frymë dhe bëjnë fjalë për parashkrimin e shkeljes disiplinore në momentin e fillimit të hetimit disiplinor. Në këtë rast hetimi disiplinor ka filluar në datën 16.05.2023, vendimi i {...} është në datën 23.10.2018, pra është brenda afatit 5-vjeçar që parashikon neni 117 i ligjit 96/2016.

Për sa i përket rastit të {...}, atëherë në këtë rast aplikohet afati 6-vjeçar për shkak të kryerjes së shkeljes me të njëjtën natyrë brenda këtij afati 5-vjeçar të parashkrimit të këtij vendimi të {...} që është i datës 27.03.2018 dhe konkretisht aplikohet ky afat 6-vjeçar për shkak të vendimeve të {...} që është më vonë në kohë, pra brenda afatit 5-vjeçar të vendimit të {...}, të {...} dhe të {...}, që janë sjellë për shkelje disiplinore. Pra shkelja e të njëjtës natyrë ka të bëjë me faktin e nenit 102/1, pika “dh”, ato që janë si të thuash shkelje disiplinore dhe jo për shkakun për të cilin është pranuar apo është rrëzuar kërkesa në rastin e {...}. Shkelja e të njëjtës natyrë nënkupton shkeljen për të cilën magjistrati është proceduar, që janë ato të dy që janë përmendur edhe në raport, pra

zbatimi i ligjit material dhe procedural dhe përfitimi i padrejtë i palëve në një proces gjyqësor.

Momenti i dytë ishte rasti që u përmend për shtetasin, ankuesin {...}, si një ankues anonim. Është e vërtetë që në datën 03.06.2023, pra disa muaj që kishte filluar, një muaj që kishte filluar hetimi disiplinor, një shtetas i quajtur edhe {...} edhe {...} (pra në deklaratë “unë i quajturi {...}”, pastaj në kartë identiteti e ka {...} dhe hajde kuptoje nëse është ky apo po luan) ka paraqitur një deklaratë noteriale ku thotë që unë nuk kam paraqitur asnjë ankesë ndaj magjistratit {...}. Kjo është me pak fjalë përmbajtja e ankesës. Kështu që në këtë kontekst, ILD nuk mund të verifikojë dot dhe të kryejë hetime nëse kemi të bëjmë me një ankues anonim apo jo, të hetojë deklaratën, pra ankesën e paraqitur në emrin e tij nëse është e falsifikuar apo jo, siç është pretenduar. Mbase ka një procedim tjetër disiplinor ose hetim për këtë fakt që e përmendi edhe magjistrati, që është drejtuar edhe Inspektori, por nuk është pjesë e hetimit tonë individual ndaj tij. Kështu që ky është rasti i {...} ose {...} (pasi i përdor të dyja këto emra). Por referuar edhe nenit 124, jo nenit 119, që Inspektori ka detyrim të shqyrtojë ankesat përveç atyre anonime, por referuar nenit 124, edhe një ankues anonim, nëse do të ishte rasti konkret, shërben për të marrë indicie për të vijuar kryesisht hetimin disiplinor. Pra parë edhe në këtë kontekst mendoj se është në rregull dhe në përputhje me ligjin 96/2016 në këtë pjesë hetimi disiplinor.

Çështjet e tjera pastaj të themelit i diskutuam, iu dhamë përgjigje. Janë pretenduar edhe nga magjistrati në vijim të parashtrimeve të tij. Ne kemi ato që janë në raport. Kështu që, s’kemi ndonjë gjë tjetër.

Ilir Rusi: Po, zoti {...}!

{...}: Personi e di se si e quaj, {...} apo {...}. Anonimin nuk e di se si e quaj. Kështu që kaq kuptohet. Ai e ka bërë shkresën me emrin e tij {...}.

{...}: Ai e ka bërë “Unë i nënshkruari {...}”.

{...}: Po, po, ashtu është.

Dhe ai e di shumë mirë. Por këtë gjë mund ta verifikonte Inspektori.

{...}: Mund t'ia lexosh edhe Këshillit si e thotë {...} apo {...}.

{...}: Po s'qenkam bindur që {...} qenka i njëjtë me {...}.

Përtej kësaj unë datën 8.07 unë i kam çuar kërkesë dhe ia kam shpjeguar, përveçse kam 2 vjet që i kërkohet të më vënë në dispozicion atë shkresën, edhe sot nuk e kanë sjellë. Prapë kërkesë të re që kanë detyrimin që tani të na vini në dispozicion, të paktën mua, të gjitha aktet që kanë shqyrtuar. Kishin detyrimin ligjor. Asnjë shkresë. Sollën një raport dhe asnjë gjë. Nuk e di nëse ia kanë sjellë anëtarëve të Këshillit të Lartë. Unë kam bërë kërkesën. Nuk e kanë sjellë. Unë kam bërë kërkesën sepse kjo është “copy-paste” e një shkrese tjetër që unë e kam vërtetuar se kush e ka bërë dhe kam që në 2022 që i them. Pastaj {...} apo {...} në përfundim të raportit, pse nuk e njoftoni ju për rezultatet e raportit por njoftoni vetëm {...}?

Përtej kësaj, në lidhje me një fakt të vogël (as 30 sekonda kohë), unë do t'ju lexoj diçka në lidhje me faktin që vetë, tek raporti tematik e kanë vërejtur inspektorët në praktikë, dhe thuhet: Në një studim të një grupi magistratësh të bërë në vitin 2020 arsyetohet se: Vlerësojmë se kërkesa pavarësisht se është bërë në një datë më të hershme sesa lejon afati ligjor nuk mundet të përbëjë pengesë ligjore kundrejt gjykatës. (*pra momenti që bëhet kërkesa në plotësimin e afatit 2/3, 3/4*). Në Gjykatën e Lartë vendimi i kolegjeve 00-2023-66 datë 13.01.2023 arsyetohet se shprehja “personi lirohet me kusht” do të thotë se kërkesa pranohet dhe personi lirohet pasi të zhvillohet një hetim gjyqësor dhe të shpallet vendimi, dhe jo në momentin që paraqitet kërkesa.

Pastaj mua më pyet: -A i kishte plotësuar apo s'i kishte plotësuar?

Ne nuk jemi këtu përballë mendimit personal që mund të ketë Inspektori. Inspektori nuk përfaqëson veten e tij këtu, përfaqëson një institucion. Ky institucioni është ky, janë të gjithë inspektorët, i miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që ka nxjerrë këtë raport. Dhe thotë këto shprehje, nëse Inspektori e vlerëson se duhet e tillë, kur të punojë nesër në sistemin prokuror, le të vete ta zbatojë dhe të bëjë debat me gjyqtarin tek lirimi me kusht, dhe të bëjë edhe ankime dhe të iniciojë një procedurë që të vejë dhe në Gjykatën Kushtetuese. Por sot këtu, mendimi i tij personal, me gjithë respektin, nuk ka vlerë. Ai përfaqëson institucionin. Institucioni është ky dhe

mendimet që institucioni jep tek raporti i vlerësimit tematik nëpër gjykata. Ai raport, ato përfundime, ato gjetje dhe ato konkluzione që unë, pavarësisht se ju i kishit, jua kam përcjellë, duhet të ishin zbatuar edhe në rastin tim. Rezulton që nuk janë zbatuar.

Ilir Rusi: Po, {...} {...}!

{...}: Meqenëse po i referohemi rastit të raportit të inspektimit tematik, shkurtimisht dua t'ju jap një informacion.

Inspektimi tematik u zhvillua për një periudhë trevjeçare duke u administruar të gjitha vendimet gjyqësore të lirimit me kusht pranë gjykatave dhe prokurorive, të cilat i kishin dhënë këto vendime, të cilat ushtronin funksionin pranë IEVP-ve. Qëllimi i këtyre ishte grumbullimi i të dhënave dhe raporti i zbatimit të ligjit material dhe procedural në dhënien e këtyre vendimeve. Nuk ishte raporti i inspektimit tematik i përqendruar në vendime konkrete. Kishte gjykata të rretheve gjyqësore që e llogarisnin 2/3 ose 3/4 në kohën kur merrej vendimi, kishte dhe gjykata të cilat e llogarisnin në kohën kur paraqitej kërkesa. Kishte vendime të tjera që interpretoheshin në mënyra të ndryshme në lidhje me zbatimin e vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë. Nga studimi trevjeçar i të gjitha vendimeve, inspektimi tematik kishte qëllime më shumë për rregullimin nëse ne mund t'i drejtoheshim për rregullimin e institutit të lirimit me kusht, neni 64, dhe Gjykatës së Lartë në lidhje me unifikimin e një praktike në lidhje me këto vendime. Në raport janë përmendur çështjet më thelbësore që kanë të bëjnë në lidhje me zbatimin e institutit të lirimit me kusht. Ndërsa, verifikimet që ne i kemi nisur dhe që mund të kemi edhe të tjera në dorë, që kanë të bëjnë po me lirimin me kusht, që kanë shërbyer pastaj si pjesë e procedimit disiplinor në vazhdimësi, nuk ishin pjesë për t'u futur tek inspektimi tematik trevjeçar. Ato që kanë qenë problematike kemi dalë me verifikim dhe jo nisje procedimi, çfarë do vazhdojë në të ardhmen. Ndërsa në lidhje me pjesën ose çfarë mund të pretendojë, dua të them që Inspektori i Lartë i Drejtësisë si institucion ka një praktikë të konsoliduar në lidhje me zbatimin e lirimit me kusht. Që nga momenti në vitin 2021 që ka ardhur grupi i inspektorëve, ne kemi paraqitur disa procedime disiplinore me lirimin me kusht edhe në një rast të vetëm. Janë gjyqtari i Gjykatës së Korçës, prokurori i Krujës, gjyqtarja e Gjykatës së Krujës dhe të gjitha këto janë në vazhdimësi të një praktike të

konsoliduar që ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe nuk është se kemi paragjykime ose synime konkrete ndaj një magjistrati të caktuar.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit {...} {...}!

Po zonja Luli!

Fatmira Luli: Atëherë, ne vërtetë kemi mbajtur dy qëndrime dhe për gjyqtarin e Korçës dhe për gjyqtarin e Elbasanit, por janë raste totalisht të ndryshme. Në ato kemi vendosur edhe standardin. E para ka qenë për vepra të rënda që i ndalon ligji për t'u bërë lirimi para kohe me kusht dhe e dyta, ka qenë për llogaritje 2-3 herë i afateve në kundërshtim me ligjin për periudha që nuk duheshin llogaritur, për të cilën e pranon dhe vetë magjistrati. Dhe kemi konstatuar që edhe lidhur me këto, Inspektori nuk ka nisur procedime edhe për raste kur janë vepruar është konstatuar nga inspektimet që ka pasur raste analoge edhe me gjyqtarë të tjerë dhe nuk është mbajtur qëndrim. Inspektimet nuk bëhen vetëm për të verifikuar situatën dhe për të bërë propozime ndryshimesh, por inspektimet bëhen edhe për të konstatuar shkeljet e gjyqtarëve dhe për t'i proceduar nëse ka vend. Ndërsa kur procedohet njëri dhe të tjerët lihen dhe nuk procedohen, ndonëse mund të kenë shkelje të rënda, ky nuk është mesazh i mirë që merr sistemi gjyqësor. Prandaj nëse do mbahet një qëndrim për inspektimet, duhet mbajtur për të gjithë në përputhje me kriteret që parashikon ligja.

{...}: Më fal! Shkurt.

Unë përmenda që, në raportin e inspektimit, nëse do ta lexoni në fund, raporti i inspektimit ka dalë tani, çështjet të cilat janë në shkelje ose janë konstatuar shkelje, ne i kemi kaluar në proces verifikimi. Çka do të thotë, ato të gjitha janë në proces verifikimi dhe nëse ato shkelje qëndrojnë, atëherë do kalojmë në procedim disiplinor. Jo se ne në këtë inspektim trevjeçar kemi anashkaluar këtë pjesë, absolutisht jo. Ne i kemi nxjerrë edhe shkelje të cilat janë në verifikim. Kemi nxjerrë edhe gjykatat përkatëse ku janë këto shkelje. Tani jemi brenda periudhës 6-mujore të verifikimit të rasteve të shkeljes. Çka do të thotë, ky inspektim, krahas ndihmës që ka dhënë në lidhje me përmirësimet ligjore,

ky inspektim ka kaluar edhe në pjesën e verifikimit. Brenda 6 muajve të këtij inspektimi, ne jemi në proces të verifikimit të konstatimeve që kanë dalë nga ky inspektim.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Gentiana Muçaj: Të bëj edhe një pyetje të fundit.

Ilir Rusi: Po, zonja Muçaj!

Gentiana Muçaj: Meqenëse po diskutojmë praktikën.

Në praktikën tuaj si ILD, me aq sa di unë kuptohet, është vazhduar edhe me marrjen e masave disiplinore ose fillim të procedimit disiplinor edhe për prokurorin që ka qenë prezent në lirimet me kusht, që sapo thamë, gjyqtarja e Krujës dhe prokurori i Krujës (të paktën ky është rasti). Në rastin konkret ka filluar ndonjë procedim ndaj prokurorit të ekzekutimeve apo në raportin përfundimtar tematik që keni bërë, ka ndonjë rekomandim?

{...}: Dalin rekomandime për të gjithë magjistratët, prokurorë ose gjyqtarë, për të cilin do fillojë verifikimi pasi të mbyllet inspektimi tematik. Për këto duhet të ketë patjetër. Por nuk i kemi ne. Mund të jenë... Se varet si ndahen pastaj për verifikim.

Gentiana Muçaj: Verifikimet janë ndarë.

{...}: Janë ndarë rastet dhe pastaj midis inspektorëve kujt do t'i caktohet, kujt do t'i bie.

{...}: Dhe vazhdon verifikimi deri në kalimin e procedimit, nëse ka të dhëna të mjaftueshme për të filluar një procedim. Në lidhje me këtë praktikën, inspektori përgjegjës që ka qenë aty ka rastet e veta, siç isha unë inspektori përgjegjës për gjykatën, prokurorinë e Korçës, apelin, dhe normalisht kam praktikën e mira, dhe unë vazhdoj me verifikimin e atyre praktikave që i kam nxjerrë.

Jo, flas nga inspektimi tematik, ne qemë të ndarë në bazë të gjykatave të rretheve gjyqësore ku janë IEVP-të dhe secili ka nxjerrë... ({...} {...} i përgjigjet një anëtari që flet pa mikrofon.) Në rastin konkret, rasti i prokurorit...

{...}: (ndërhyn) Verifikimi kishte nisur.

Po pra, ishte mbi bazë ankese dhe kishte nisur.

{...}: Edhe diçka.

Të gjitha rastet, të gjitha verifikimet në këtë rast kanë qenë mbi bazën e ankesave.

{...} Luli flet pa ndezur mikrofonin: ... nëse ankesa është e falsifikuar, në të dyja rastet vendimmarrja juaj duhet të jetë në bazë të ligjit.

{...}: Edhe në bazë të ligjit, të shpjegojmë. Ankesat kanë qenë konkrete ndaj magjistratit, nuk ka pasur asnjë pretendim. Vendimi ka marrë formë të prerë. Është ekzekutuar nga prokurori. Në rastin {...}, {...}, ankesa është adresuar mbi një çështje konkrete duke u ngritur pretendime ndaj kësaj çështjeje konkrete. Dhe ky ka qenë rasti kur është bërë shqyrtimi fillestar i kësaj ankese, i të gjitha ankesave. Rasti i magjistratit {...} ka qenë mbi bazën e ankesave dhe ka vazhduar.

Në lidhje me inspektimin tematik, është pjesë tjetër e verifikimeve.

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

Edhe një herë, inspektimi tematik ka qenë në proces dhe është në pjesën përfundimtare. Po të shohësh raportin, raporti ka dalë tani. Ndërsa pjesa e verifikimit dhe hetimit disiplinor ka qenë krahasim paralelisht me këtë, por kjo nuk do të thotë që po bëhet vetëm për magjistratin {...} dhe për magjistratët e tjerë nuk po vijon. Nga inspektimi tematik ne kemi kaluar në verifikimin e shumë çështjeve të cilat brenda afatit të caktuar do procedohet..

Ilir Rusi: Faleminderit {...} {...}!

Po zoti {...}, fjala për ju!

{...}: Ajo ankesa që është për {...} ka lidhje, nuk përmend vetëm {...}, ka edhe një Krenar Mama aty për qëndrim në shtëpi. Pra janë dy veta. Ka edhe pretendime që unë abuzoj me karburantin e gjykatës. Besoj e keni lexuar. Ka edhe pretendime që unë abuzoj me marrjen e personelit në punë. Ka pretendime që unë abuzoj me orarin. Domethënë unë abuzoj në çdo gjë. Ka pretendime që kam qenë i dënuar penalisht më parë se të bëhesha gjyqtar. Dhe mbyllet, “po ky kriminel pse rri në sistemin e drejtësisë?” – E quani ankim ju këtë, për një çështje të caktuar? Prandaj nuk e sollët ju sot atë letrën që ta shikonin dhe ta lexonin të gjithë. Dhe e fshihni. Unë nuk e kam parë dhe ju kam bërë kaq kërkesa për të ma sjellë atë. Edhe prokurorit në Sarandë ia kam kërkuar që ta marri, edhe ai nuk e merr, ka dy vjet që e mban çështjen, që rri atje. Tani në qoftë se kjo quhet ankim, që ky kriminel që liron përditë. Ankesë është kjo? Më vjen keq tani se ne jemi profesionistë.

Të lutem, se nuk dua ta bëj debat, të lutem. Por kjo është ajo përmbajtja. Që në pamjen e parë kjo nuk është ankesë. Kjo është një letër që duhet t’i ishte treguar vendi proceduralisht dhe ligjërisht ose mundësisht ai personi kur thotë që nuk jam unë, duhet të ishte thirrur.

Në lidhje me... të lutem.

{...}: Jo, jo, më fal. Shumë shkurt.

Letra i është dërguar shumë institucioneve, ndërsa tek ne ka ardhur ankesa konkrete me emrin e të pandehurit dhe me vendimin që është dhënë.

{...}: Po a mund të ma jepni mua ta di unë këtë, se kam tre vjet që e kërkoj.

{...}: Të gjithë dokumentacionin e kemi dorëzuar në KLGJ dhe është administruar.

{...}: Po mua nuk ma jepnit dot apo s’duhet ta merrja unë?

Mirë, e nderuara {...} anëtare bëri pyetje dhe tha që kush janë një shkak, një shkelje dhe tha aplikimi i 2/3, 3/4 apo edhe momenti i paraqitjes.

Momentin e paraqitjes unë e referova dhe është vendimi i Gjykatës së Lartë. Unë kam të njëjtën praktikë me vendimin e Gjykatës së Lartë në lidhje me kohën e

përlllogaritjes, pra jo në momentin që dorëzohet kërkesa, por në momentin që shpallet vendimi.

Në lidhje me aplikimin e 2/3 ose 3/4 mbi masën e dënimit apo mbi çfarë parashikon ligji, unë përsëri i referohem vendimit të Gjykatës së Lartë, që më ndihmoi në rastin konkret sepse nuk e dija (s'është se kisha zhbiruar shumë tek kjo fushë), më ndihmuan inspektorët dhe unë po lexoj, e kam në faqen 8 të parashtrimeve, që unë e kam sjellë, dhe thotë: “Gjykata e Lartë, vendimi i datës 03.11.2022, [...] evidentohet një rast kur interpretimi i nenit 64 i K.Penal është bërë objekt trajtimi duke përcaktuar qartë praktikën që duhet të ndiqet sipas vendimit të trupës gjyquese. Rasti në fjalë i përket një vendimi kolegji dhe i përket shqyrtimit të kërkesës së një të dënuari për veprën penale të “trafikimit”, është dënuar me 4 vjet burg, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe apeli Tiranë në përlllogaritjen e vuajtjes së dënimit kanë mbajtur praktikën e parë referuar masës së dënimit që parashikon dispozita përkatëse për të cilën është deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuesi. Nga ana e Gjykatës së Lartë është vlerësuar se referimi sipas praktikës së parë nuk është interpretim i saktë i nenit 64 të K.Penal, por interpretimi sipas praktikës së dytë. Një interpretim i tillë i kolegjit penal, referuar të dhënave të administruara për efekt të këtij inspektimi, përkon me praktikën e ndjekur nga një numër i vogël magistratësh dhe pavarësisht se nuk është e karakterit unifikues që mund të jetë e nevojshme për të gjitha rastet sipas parashikimit të nenit ... do të ketë impaktin e saj tek magistratët e praktikës tjetër.” Dhe pastaj vazhdon që do të vlerësohet.

Pra në rastin konkret, siç u shpreh edhe Inspektori vetë, tek të gjitha është aplikuar 3/4, por edhe nëse do aplikojta 2/3 unë jam në rregull me vendimin e Gjykatës së Lartë. Tani t'i zbatojmë vendimet e Gjykatës së Lartë apo mos t'i zbatojmë?

Nuk kam ndonjë gjë tjetër për të shtuar sepse do bie në përsëritje.

Alban Toro: Më lejo të bëj një pyetje meqenëse ma tërhoqe vëmendjen me atë.. dhe u krijua problemi i parashkrimit. Për ju momenti i parashkrimit fillon nga momenti i fillimit të hetimit të procedimit disiplinor apo nga momenti kur është bërë shkelja? Kaq doja.

Ndërkohë që për magistratin do dëshiroja...

{...}: Afati fillon në momentin e kryerjes, nga momenti që është kryer shkelja disiplinore dhe unë i përmenda edhe dispozitat ku përmendet shprehimisht kur mbyllet hetimi e kur mbyllet procedimi disiplinor. Vetë neni 117 është fillimi i hetimit disiplinor. Pra nëse fillon hetimi disiplinor nuk mund të diskutohet më për parashkrim, është kapur afati i parashkrimit 5-vjeçar nga momenti i kryerjes së shkeljes disiplinore, ashtu siç dispozitat e tjera (*nuk kuptohen në audio nenet që citon z. {...}*) që parashikojnë pezullimin e hetimit disiplinor i cili e ndërpret afatin e parashkrimit. E thotë shprehimisht. Pra është shumë e qartë në këto dispozita që momenti i fillimit është momenti i kryerjes së shkeljes disiplinore, dhe i përfundimit është momenti i fillimit të hetimit disiplinor.

Alban Toro: Faleminderit!

Në sekretari kenë depozituar disa akte.

Aktet dëshironi t'i administrojmë? Nëse po, duhet t'i japim një kopje palës tjetër? Dhe çfarë doni të provoni me ato akte?

{...}: Faleminderit!

Sigurisht që dëshiroj që të administrohen të gjitha aktet që unë kam paraqitur. Të vlerësohen në raport me kundërshtimet e parashtruara me shkrim, të cilat në shumicë të madhe janë ato që u debatuan këtu në seancë. Sigurisht, nëse dëshiron le të marri edhe një kopje, është e drejtë e saj dhe e palës tjetër (të inspektorëve). Kjo për sa i përket procedurës së administrimit të provave.

Alban Toro: A ke një listë të akteve që ke depozituar inventar, në mënyrë që t'ia bëjmë të ditur edhe palës tjetër, se do të japim një kopje apo jo.

{...}: Po, në dy faqet e fundit të parashtrimeve të mia, unë them që bashkangjitur materialit kundërshtues janë edhe [...] (dhe i citoj të gjitha). Janë 15 pika. Janë të gjitha aktet, që janë dosjet që ne shqyrtojmë; janë vendimi “për lirimin me kusht”. Ato të rrëzimit që inspektori sapo tha që ne i kemi evidentuar por nuk kemi gjetur shkelje edhe tek vendimet e rrëzimit edhe tek vendimet e tjera. Pra janë vendime që janë brenda

periudhës së inspektimit, që unë jam i sigurt që këto janë vlerësuar nga inspektorët. Janë vetëm vendimet e uljes së dënimit të dhëna prej meje por që unë besoj që këto thjesht tregojnë një praktikë, por që nuk e di se sa rëndësi kanë, për sa kohë unë mendimin për ulje dënimi e vlerësoj të drejtë edhe në raport me provat që kam administruar në atë gjykim. Kurse shkresa dërguar ILD-së në 08.07.2022 në lidhje me informacion për ankesën, pra për gjyqtaren; shkresën e përsëritur të datës 30.07.2022, pasi s’kisha marrë... Kam çuar materialet... Ia kam çuar materialet e kallëzimit penal, ia kam çuar Inspektorit ku çështja ka ikur për moskompetencë, pasi u evidentua që ishte gjyqtare personi që bënte letrat në emër të një avokati. U evidentua me prova filmike që ishte gjyqtare e asaj gjykate dhe ka ikur për kompetencë në Prokurorinë e Sarandës. Dhe kopja e raportit tematik tek pjesa e “vlerësime” që ju e keni. Në vlerësim të Inspektorit nëse do ose jo të marri aktet që unë kam paraqitur si provë.

Ilir Rusi: Atëherë, besoj se me këto diskutime, ndërveprimi përfundoi.

Atëherë ftoj përfaqësuesit e ILD-së dhe magjistratin z. {...} të largohen, me qëllim që KLGJ të vijojë me shqyrtimin e mëtejshëm.

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së, znj. {...} dhe z. {...}, si dhe gjyqtari z. {...}).

Ilir Rusi: Atëherë, ju falënderoj për durimin e deritanishëm.

Në vijim të këtij procedimi disiplinor dhe kësaj seance dëgjimore, ju bëj me dije që deri tani janë paraqitur një dosje nga ILD, gjithashtu më datë 12.03.2024 janë paraqitur parashtrime dhe një dosje gjyqësore të çështjeve të pretenduara nga magjistrati.

Në vijim të këtij procedimi disiplinor propozoj që t’i vihet në dispozicion dosja e ardhur nga e ILD-së magjistratit z. {...}, gjithashtu edhe të merren për shqyrtim, dosja gjyqësore e paraqitur nga magjistrati z. {...} në datë 12.03.2024 dhe mendoj që nëse jeni dakord me këtë propozim, seanca e radhës në lidhje me këtë procedim disiplinor të jetë më datë 09.04.2024, ditë e martë, ora 13:00.

Keni diskutime për sa u propozua?

Meqenëse nuk ka diskutime, kalojmë në votimin e propozimit të bërë nga unë si relator, njëkohësisht edhe drejtues i seancës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Për racionalizim dhe efektivitet të kohës, ftoj administratën të njoftojë përfaqësuesit e ILD-së dhe magistratin për t'i komunikuar vendimmarrjen e tanishme e Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me këtë procedim disiplinor.

(Rifuten në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së, znj. {...} dhe z. {...}, si dhe gjyqtari z. {...}).

Ilir Rusi: Në vijim të këtij procedimi disiplinor dhe pasi dëgjoi palët subjekt të këtij procedimi disiplinor, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi për t'i komunikuar të gjithë dosjen e dorëzuar deri më tani nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë magistratit z. {...}. Njëkohësisht në seancën e radhës që do të jetë në datën 09.04.2024, ora 13:00 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të paraqesin edhe parashtrimet përkatëse. Gjithashtu ju bëj me dije që çfarë është dorëzuar nga ana juaj deri më tani janë administruar si prova nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së, znj. {...} dhe z. {...}, si dhe gjyqtari z. {...}).

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.03.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi, në mungesës, akti relatohet nga z. Toro):

2.1 Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 252 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

2.2 Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 14:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

- | | |
|--------------------------|------------------|
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala, eksperte të EWMI.**
- 6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi, në mungesës, akti relatohet nga z. Toro):

2.1 Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 252 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

2.2 Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vijon mbledhja pas disa minutash pushim.

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të kësaj mbledhjeje, ju bëj me dije që për gjatë ditës ka ardhur një kërkesë për caktimin e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Jeni dakord për ta përfshirë në këtë rend dite?

(Çështja është e përfshirë në rendin e ditës.)

Dakord atëherë.

Vazhdojmë atëherë më pikën 2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, materialet të cilat janë përgatitur do të relatohen nga z. Toro.

Alban Toro: Relacioni bashkëlidhur ka dy projektvendime.

Relacioni ka lidhje me fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 për kandidatët që kanë ose nuk mund të kenë asnjë vlerësim, si dhe për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për këto kandidatë në këtë pozicion.

Me disa vendime, siç e theksova edhe më lart, të datës 24.05.2023, nga ana e Këshillit janë hapur 8 procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ndër to, me vendimin nr. 252, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

Me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, është miratuar lista e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime/ 1 vlerësim/ pa vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatën e Elbasanit dhe Lezhës. Në këtë listë janë përfshirë gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë.

Në vijim, me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023 është vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallura me vendimet nr. 249 dhe 252 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim”, si dhe njëkohësisht është filluar

edhe procedura e verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 248, 250, 251, 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”. Lista e kandidatëve për pozicionin nr. 252 është si më poshtë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Ndërkohë zonja {...} më datë 29.02.2024 ka paraqitur dorëheqje nga ky kandidim dhe dorëheqja e saj është pasqyruar me vendimin ku është vendosur përfundimi i procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë të shpallur, me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 për kandidaten znj. Xhani për shkak të dorëheqjes së saj.

Ndërkohë, më pas ka pasur evoluime të tjera ku në datë 29.04.2024 (*lapsus data, është 29.02.2024*) është paraqitur një kërkesë për tërheqje nga kandidimi për pozicionin nr. 252 edhe nga kandidate {...}. Kandidatët e tjerë në këtë pozicion- znj. {...} është transferuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (pozicioni 21); znj. {...} është transferuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (pozicioni 15); znj. {...} është transferuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (pozicioni 253); Pas tërheqjeve të sipërcituara, kandidate që mbetet në garë për pozicionin nr. 252 është znj. {...}. Kjo kandidate sipas Shtojcës III të vendimit nr. 346, datë 27.06.2023, rezulton se nuk ka dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Në lidhje me fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, janë kryer këto veprime procedurale.

Me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, Këshilli ka vendosur: Miratimin e listës së gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit nr.248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257

dhe 258, datë 24.05.2023, sipas Shtojcës III bashkëngjitur këtij vendimi. Në shtojcën III janë lista e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Nga lista e gjyqtarëve të përfshirë në Shtojcën III, rezulton 1 (një) prej tyre ka kandiduar në pozicionin nr. 252 dhe kjo është znj. {...} – gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Në këto kushte, në përputhje me pikën 11 të vendimit, nr. 252, datë 24.05.2023, vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, Komisioni i ka propozuar Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Në pikën e dytë është parashikuar një rregullim i veçantë për kandidaten znj. {...}, e cila është kualifikuar më parë në procedurat e lëvizjes paralele konkretisht, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023 me vendimin nr. 465, datë 25.07.2023. Në përputhje me pikën 53 të vendimit të Këshillit nr. 320, procedura e verifikimit të kriterëve ligjore që ka përfunduar për këtë kandidim, është e vlefshme edhe për pozicionin e hapur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi procedurat janë të njëkohshme dhe në të njëjtën fushë, pra atë penale.

Meqenëse kjo kandidate e vetme, është e kualifikuar, Komisioni propozon që të vijohet me projektvendimin për caktimin e relatorit të përzgjedhjes për pozicionin nr. 252.

Pra bashkëlidhur ju do të gjeni dy projektvendime, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1.Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 252 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim.

2. Për kandidaten znj. {...}, e cila ka kandiduar në procedurat e lëvizjes paralele, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023, procedura e verifikimit të kriterëve ligjore që ka përfunduar për këtë

kandidim, është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për lëvizjen paralele, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë që në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së kësaj kandidateje është propozuar projekt-akti i dytë në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

Fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Caktimin e relatorit si më poshtë, pra relator i cili do të dalë pas relativitetit të këtij akti nëpërmjet shortit të hedhur nga sekretaria e nëpunësve të KLGJ-së.

Ky ishte pak a shumë materiali i përgatitur nga ana e Komisionit ku janë materializuar edhe propozimet përkatëse tek projektvendimet.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Në mënyrë të përmbledhur u relatua relacioni për dy projekt-aktet.

Fillimisht hedhim në votim projekt-aktin e parë që ka të bëjë me “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim.

2. Për kandidaten znj. {...}, e cila ka kandiduar në procedurat e lëvizjes paralele, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023, procedura e verifikimit të kritereve ligjore që ka përfunduar për këtë kandidatim, është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për lëvizjen paralele, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Në vijim, ka diskutime në lidhje me projekt-aktin e dytë mbi mekanizmin e prezantuar nga relatori në lidhje me hedhjen e shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën për të hedhur shortin.

Procedura e shortit si vijon:

Në një enë futen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Alban Toro, z. Klodian Kurushi, z. Markelian Koça.

Procedura e përzgjedhjes:

Nga shorti përzgjidhet relator z. Alban Toro.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime në lidhje me mënyrën e hedhjes së shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, pas hedhjes së shortit, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës me përditësimet e nxjerra nga shorti.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit, si më poshtë:

Për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023, relator z. Alban Toro.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.03.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 14:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte të EWMI.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 3 të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Me vendimet nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur hapja e procedurës për ngritje në detyrë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.

Ka rezultuar se brenda afatit të caktuar me vendimin e KLGJ-së ka kandiduar edhe kandidati z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Po ashtu, me vendimin nr. 57, datë 07.02.2024 të Këshillit janë filluar procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidatit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira, ndërmjet të cilave edhe dy vendimet që sapo citova më sipër, nr. 244 dhe nr. 246.

Nga shorti jam caktuar unë si relator i kësaj çështjeje.

Në rrugë elektronike më datë 11.03.2024, kandidati z. {...} ka parashtruar kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023.

Në referim të vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, sipas të cilit përcaktohet se: përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim çështjen përpara Komisionit, pra çështja i ka kaluar nga ana ime si relator Komisionit.

Në mbledhjen e datës 12.03.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për kandidatin z. {...}, si dhe po ashtu, vlerëson të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur për t’u tërhequr nga kandidimi, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023, bazuar në pikat 17, Seksioni B dhe 3, Seksioni C, të Kreut VI të vendimit nr. 75/2019, vendosi dërgimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm Tiranë, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.
Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Hado!

Ka diskutime?

Po theksoj faktin që në votimin e këtij projektvendimi nuk merr pjesë anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Markelian Koça për shkak të konfliktit të interesit deklaruar kohë më parë.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.03.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Yllka Rupa.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 14:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 9. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte të EWMI.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore *znj. Yllka Rupa*.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga *znj. Rupa*. Për më tej fjalën *znj. Rupa*.

Ndërkohë bëj me dije se nga ana e gjyqtares nuk ka kundërshtime.

Yllka Rupa: Në cilësinë e relatores po paraqes projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren {...}, i cili ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, gradimin e gjyqtares, e cila ka kaluar procesin e vlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë.

Në projektraport pasqyrohet sipas rendit kronologjik i gjithë procesi vlerësues i gradimit të gjyqtares, procedura në mënyrë të plotë, burimet e vlerësimit, kështu që në

mënyrë të përmbledhur do të relatoj lidhur me nivelin e pikëzimit dhe të vlerësimit për gjithsecilin nga katër kriteret vlerësuese.

Për të filluar me aftësitë profesionale të gjyqtarës, në aspektin e njohurive ligjore, 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

1.A.b. Aftësitë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtarja {...} ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material. Dispozitat e ligjit rezulton të jenë referuar dhe interpretuar plotësisht nga ana e gjyqtarës duke zbërthyer në elementët përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës, para aplikimit të tyre mbi faktet e çështjeve konkrete. Kështu që në lidhje me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Për të kaluar tek 1.B. Arsyetimi ligjor, si në aspektin e 1.B.a. Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit ashtu edhe në aspektin e 1.B.b. Strukturës dhe qëndrueshmërisë së tij propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët respektivisht 15 dhe 10 për gjyqtaren.

Në lidhje me 1.B.c. Cilësinë e analizës dhe argumentit logjik, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë për këtë tregues për arsye se arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, si në çështjet civile, ashtu edhe në çështjet penale. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Kështu që në lidhje me “Aftësitë profesionale të gjyqtarës” propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë organizative të gjyqtarës”, 2.A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, në lidhje me 2.A.a. Respektimin e afateve ligjore. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues,

rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në këtë drejtim. Propozohet niveli i pikëzimit me 15 pikë.

Për sa i takon 2.A.b. Plotësimin të standardeve minimale kohore rezulton që në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja. Rezulton se nga 13 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, jo të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, pasi 7 prej tyre kanë përfunduar tej afatit standard minimal kohor të përcaktuar për secilën kategori. Pra në total 53.8% e çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor. Kjo përqindje përkon me nivelin e vlerësimit me 1 pikë, por duke qenë se vlerësuesi bën edhe një analizë logjike të fakteve, në pikëzimin e këtij kriteri jam mbështetur në raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuara që rezulton në masën 50%; faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit; kalimin e standardit sasior të zbatueshëm mesatarisht me 17%. Për këto arsye propozoj që lidhur me këtë tregues, rritet niveli i vlerësimit të gjyqtares në 3 pikë, duke mos pasur mundësi në rritjen maksimale të vlerësimit për këtë tregues, pasi nuk tejkalohet standardi me 50%.

Për të kaluar tek komponenti tjetër 2.A.c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje. Vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.

Referuar analizës matematikore, koha mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjysmën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 3 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo

çështjeje, tejkalohe vetëm për një kategori (civile themeli), me 1 muaj e 10 ditë, si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja, lidhur me gjykimin e kësaj kategorie çështjesh, vlerësoj se ky tregues duhet të pikëzohet në nivelin maksimal me 5 pikë.

Lidhur me 2.A.ç. Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 85.3%. Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja e mësipërme pikëzohet me 4 pikë. Por në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë. Në këto kushte unë propozoj që lidhur me këtë tregues gjyqtarja të pikëzohet në nivelin e 8 pikëve.

Për të kaluar tek 2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor. Ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short. Nga analiza e të dhënave, duke iu referuar burimeve të vlerësimit “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” rezulton “Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve”. Tejkalimi i aftit të arsyetimit të vendimeve është bërë vetëm për një nga kategoritë, konkretisht për çështjet e kategorisë civile. Për këto arsye unë mendoj që në lidhje me vlerësimin e këtij treguesi, të aplikohet koeficienti i vlerësimit 20% dhe gjyqtarja të vlerësohet me 15 pikë.

Në lidhje me 2.B. Aftësinë e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore, 2.B.a. Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive, nga tërësia e të dhënave rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtarë varion nga 1 deri në 13 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton 3 seanca gjyqësore për çështjet familjare dhe 4.5 seanca gjyqësore civile me palë kundërshtarë. Në total, numri mesatar i seancave është 3.7 seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Nga vëzhgimi i 11 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil, kështu që propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit me 15 pikë.

Në lidhje me komponentin 2.B.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit, në seancat gjyqësore të zhvilluara. Kështu që propozohet lidhur me këtë komponent niveli i vlerësimit me 20 pikë.

Në lidhje me 2.C. Aftësitë e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore, në të dy komponentët e këtij nënkriteri, si në aspektin e 2.C.a. Rregullshmërisë së dosjes ashtu edhe në aspektin e 2.C.b. Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit, propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi, përkatësisht pikët 5 dhe 10.

Kështu që në lidhje me “Aftësitë organizative të gjyqtares” niveli i vlerësimit propozohet të jetë “Shkëlqyeshëm”, pikët 96.

Për të kaluar tek kriteri tjetër “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”. Për të gjithë treguesit e këtij kriteri gjyqtarja është vlerësuar me pikët maksimale për arsye sepse në lidhje me “Etikën në punë”, “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion”, gjyqtarja rezulton se ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion. Gjithashtu nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj; nuk përdor gjuhë diskriminuese; gjithashtu nuk rezulton, nuk ka asnjë të dhënë lidhur me numrin tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Në lidhje me kriterin “Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional”, 4.A Aftësitë e komunikimit, 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent, rezulton që referuar të dhënave gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si

dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Për sa i takon 4.A.b Respektimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Propozohet niveli i vlerësimit i lartë, pikëzimi 15.

Po ashtu edhe aftësia për të bashkëpunuar si në aspektin e 4.B.a Shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës me to, po ashtu edhe në aspektin e 4.B.b Komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, rezulton që gjyqtarja të jetë në nivelin shumë të lartë, pikëzimi 15 dhe 10 për secilin nga këto dy komponentë.

Në lidhje me 4.C. Gatishmërinë e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, për sa i takon treguesit 4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile, procedurale, ndërkombëtare dhe familjare, gjithsej 8 aktivitete, të zhvilluara për 13 ditë, që do të thotë se është në respektim të parashikimeve ligjore. Kështu që propozohet lidhur me këtë tregues niveli i pikëzimit me 20 pikë.

Për sa i takon 4.C.b. Disponueshmërisë së gjyqtarës për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional ose për trajnimin e gjyqtarëve, nuk rezulton që lidhur me këtë tregues të ketë diçka të dokumentuar nga gjyqtarja, kështu që vlerësohet me 3 pikë lidhur me këtë tregues.

Për sa i takon 4.C.c. Angazhimit të gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtarja rezulton të jetë angazhuar në veprimtari të tilla dhe ka një rol aktiv në to, kështu që vlerësohet me 5 pikë.

Po ashtu lidhur me 4.C.ç. Publikimet ligjore nuk rezulton të ketë publikime ligjore, kështu që për këtë komponent nuk vlerësohet.

Niveli i vlerësimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional për gjyqtaren” propozohet të jetë niveli “Shkëlqyeshëm”, pikët 93.

Në lidhje me vlerësimin për çdo kriter propozohet të jetë si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";

Aftësitë organizative të gjyqtarit, pikët 96, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, pikët 93, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Kështu që niveli i përgjithshëm i vlerësimit për gjyqtaren propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm", niveli i pikëzimit 389. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, kalojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.03.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244, nr. 245 datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 14:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte të EWMI.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244, nr. 245 datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 5, për të cilën theksoj që zoti Koça nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe vendimmarrjen e këtij vendimi, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244, nr. 245 datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është

përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Me vendimet nr. 241, nr. 244, nr. 245, datë 24.05.2023 të KLGJ-së është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë për gjyqtarët pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e së drejtës civile. Brenda afatit të caktuar nga vendimi i Këshillit ka kandiduar edhe zonja {...}.

Me vendimin nr. 57 datë 07.02.2024, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura në datën 24.05.2023 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Nga shorti jam caktuar unë si relator i kësaj çështjeje.

Nga verifikimi paraprak i tre kriterëve rezulton se nga të dhënat e administruara kandidatja {...} deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244, nr. 245, datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Gjithashtu rezulton nga dokumentacioni i administruar, se deri në momentin e kandidimit, rezulton se kandidatja znj. {...} të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Gjithashtu nuk rezulton që të ketë masë nga dokumentacioni i administruar. Nga verifikimet nuk rezulton që zonja {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Po ashtu nuk është në kushtet e papajtueshmërisë ambientale.

Në datë 07.03.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit të znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, vendosi t'ia kalojë mbledhjes plenare për vijimin e mëtejshëm të procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Hado!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244, nr. 245, datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245, datë 24.05.2023 të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.03.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 246, nr. 247 datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 14:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte të EWMI.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 246, nr. 247 datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Ilir Rusi: Për më tej vazhdojmë me pikën 6 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 246, nr. 247, datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ndërkohë theksoj faktin që edhe në këtë shqyrtim të këtij projektvendimi nuk merr pjesë anëtari z. Koça.

Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Me vendimet nr. 241, nr. 246, nr. 247, datë 24.05.2023 KLGJ-ja ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e së drejtës civile.

Brenda afateve të përcaktuara në vendimmarrjen e Këshillit ka kandiduar edhe zonja {...}. Po ashtu Këshilli me vendimin nr. 57, datë 07.02.2024 ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e datës 24.05.2023 të Këshillit.

Nga shorti jam caktuar unë si relator i kësaj çështjeje.

Nga verifikimet paraprake për tre kriteret për zonjën {...} rezulton nga dokumentacioni i administruar se ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Po ashtu rezulton që të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës civile.

Nga dokumentacioni i administruar nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Gjithashtu nga verifikimi i kriterit të papajtueshmërisë ambientale nuk rezulton që të jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast se ngrihet në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në datën 05.03.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit të znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, bazuar në vendimin 75/2019 të Këshillit, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për: Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm,

për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Si dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të sipërcituara. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Hado!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 246, nr. 247 datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.03.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 240, nr. 245, nr. 247 datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 14:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte të EWMI.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 240, nr. 245, nr. 247 datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 7 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 240, nr. 245, nr. 247, datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Edhe në këtë pikë, për shqyrtimin e saj, nuk merr pjesë z. Koça.

Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Me vendimet nr. 240, nr. 245, nr. 247, datë 24.05.2023 të KLGJ-së është vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e së drejtës civile.

Brenda afatit ka kandiduar edhe zonja {...}. Po ashtu Këshilli me vendimin nr. 57, datë 07.02.2024 ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e datës 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga shorti jam caktuar unë si relator i kësaj çështjeje.

Nga verifikimi paraprak për tre kriteret e kandidimit rezulton se ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë, znj. {...}.

Po ashtu nga dokumentacioni i administruar rezulton se zonja {...} deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e sipërcituara, ka mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës civile. *(ndërpritet audio).*

Nuk rezulton që zonja {...} ka masë disiplinore.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet ndonjë situatë papajtueshmërie ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në mbledhjen e tij Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në datën 05.03.2024, duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit të znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e sipërcituara, në referim të vendimit 75/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur lidhur me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr.

240, nr. 245 dhe nr. 247, datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Si dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të sipërcituara. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Hado!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 240, nr. 245, nr. 247, datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 240, nr. 245 dhe nr. 247, datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 240, nr. 245 dhe nr. 247, datë 24.05.2023.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.03.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi, në mungesë çështja relatohet nga z. Toro).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 14:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje është përmbledhje.

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në këtë çështje, z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte të EWMI.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi, në mungesë çështja relatohet nga z. Toro).

Çështja e fundit në rendin e ditës lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Alban Toro për të relatuar relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Zoti Toro parashtron deri më datë 19.03.2024, pranë KLGJ-së, është regjistruar për trajtim kërkesa për caktimin e 2 gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Në relacion është paraqitur lista e gjyqtarëve të cilët kanë pengesë ligjore për të marrë pjesë në short.

Zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit është i pamundur për shkak se nuk ka gjyqtarë që plotësojnë kushtet e sigurisë siç kërkohet nga shkronja “b”, pika 4, e nenit 45, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”. Gjithashtu edhe zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm është i mundur për shkak se ka një ndalim ligjor të parashikuar në pikën 8 të nenit 42 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”. Ndaj për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në këtë kuadër Komisioni propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Numri i gjyqtarëve të jetë dy.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Është parashikuar gjithashtu lista e gjyqtarëve që janë përjashtuar nga shorti, gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, si dhe gjyqtarët që kanë një ngarkesë dhe që janë shortuar së fundmi nga KLGJ-ja dhe që janë, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}.

Bashkëlidhur është edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret për të qenë pjesë e shortit.

Pas parashtrimit të z. Toro, anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen penale nr. 65, datë 08.03.2024 gjyqtarët e përzgjedhur janë z. Sokol Shehu dhe z. Sokol Pasho.

Me shqyrtimin e kësaj çështjeje, mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhje deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor